

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligji “Për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit...
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Zhvillim
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Direktiva (BE) 2017/1132</b> e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 qershorit 2017 lidhur me disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (kodifikim), FZ L 169, 30.6.2017, f. 46–127, ndryshuar kryesisht nga <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) <b>Direktiva (BE) 2019/1151</b> e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 qershorit 2019, që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket përdorimit të mjeteve dhe proceseve digjitale në të drejtën e shoqërive tregtare, PE/25/2019/REV/1, FZ L 186, 11.7.2019, f. 80–104</li> <li>(ii) <b>Direktiva (BE) 2019/2121</b> e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 nëntorit 2019, që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare, PE/84/2019/REV/1, OJ L 321, 12.12.2019, f. 1–44</li> </ul> </li> </ul>
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027  Dokumenti i Vlerësimit të Ndikimit të Politikave
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	Data/Asnjë konsultim publik.
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Data e vlerësimit të ndikimit

<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	Po/Jo Data e shqyrtimit
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)</b>	
<b>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</b>	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	
<p>Procesi i harmonizimit të legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri me acquis-in e Bashkimit Evropian, nën Kapitullin 6, është një aspekt kyç i integritimit të Shqipërisë në BE. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me rregulloret e BE-së është thelbësor për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke krijuar një mjedis të transparencës, konkurrencës dhe rritjes. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për vitin 2024, Shqipëria është përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e ligjit të shoqërive tregtare.</p> <p>Edhe pse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmbushur kërkesat e BE-së, Shqipëria ende përballet me boshllëqe veçanërisht në lidhje me shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare.</p> <p>Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të adresuar këto boshllëqe, për të krijuar një kuadër ligjor të qartë dhe të qëndrueshëm që do të sigurojë transparencë dhe siguri ligjore për bizneset, si dhe do të përmirësojë mjedisin e investimeve dhe integrimin në tregun e BE-së. Pasoja e këtij procesi është përmirësimi i konkurrueshmërisë së Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare dhe përmbushja e kërkesave për anëtarësim të plotë në BE.</p>	
<b>OBJEKTIVAT</b>	
<i>Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)</i>	
<p>Ky vlerësim i ndikimit rregullator (RIA) për harmonizimin e kushteve të shndërrimit, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare siç janë parashikuar në Direktivën 2017/1132 , konkretisht ndryshimet e sjellja nga Direktiva (BE) 2019/2121 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 nëntorit 2019, që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare, ka si objektivi sigurimin e përputhshmërisë të ligjit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian. Ky proces ka si qëllim krijimin e një mjedisi ligjor të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent për bizneset dhe investitorët.. Po ashtu, ky vlerësim adreson nevojën për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe krijimin e një infrastrukture digjitale që do të mundësojë operacione të përbashkëta ndërkufitare dhe përputhshmëri me kërkesat e BE-së. Objektivat specifike janë:</p> <p>Përshtatja e kuadrit ligjor për shndërrime, bashkime dhe ndarje ndërkufitare, në përputhje me kërkesat e Direktivës, përkufizimin e qartë të procedurave ligjore (ndikimi tek regjistrimet, marrëveshjet e veçanta, organet e negocimit), duke garantuar transparencë dhe parashikueshmëri për shoqëritë shqiptare dhe ndërkombëtare që kryejnë operacione ndërkufitare, parashikimin e mekanizmave mbrojtës për aksionarët (përfshirë blerjen e pjesës së aksionarëve kundërshtues), kreditorët dhe punonjësit në rastet e operacioneve ndërkufitare dhe më në përgjithësi, krijimin e një mjedisi ligjor më të favorshëm për investimet e huaja dhe për veprimet ndërkufitare, me rritjen e</p>	

besueshmërisë ligjore dhe efikasitetit në tregun e brendshëm. Kjo pritet të rrisë transparencën dhe konkurrencën, duke mbështetur zhvillimin ekonomik.

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

**Opsioni 0 (status quo)**- nënkupton vijimin me kuadrin ligjor aktual. Ky nuk është një opsion i përshtatshëm për t'u zbatuar sepse mbajtja e kuadrit ligjor aktual do të çonte në mos përputhshmëri totale me kërkesat për shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare dhe mospërputhje të pjesshme me bashkimet ndërkufitare.

**Opsioni 1 (Miratimi i një ligji të ri për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare) i preferuar** -nënkupton hartimin e një ligji të ri për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare që do të sillte dhe shfuqizimin e ligjit aktual nr. 110/2012 "Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare". Natyra e shtesave ligjore të ndërmarra në nivel BE-je dhe prezantuar me Direktivën 2019/2121 janë të një volumi aq të madh sa shtesat dhe ndryshimet e reja në formë dhe përmbajtje tejkalojnë në mënyrë të rëndësishme strukturën e ligjit aktual duke e bërë amendimin një qasje jo të përshtatshme. Për hir qartësie ligjore dhe kuptimi të ndryshimeve për qëllim harmonizimi është e nevojshme të hartohet një ligj tërësisht i ri sepse shndërrimet dhe ndarjet mungojnë tërësisht në ligjin aktual ndërsa bashkimet ndërkufitare afektohen thellësisht nga ndryshimet e vitit 2021 në Direktivë.

**Opsioni 2 (ndryshimi i ligjit ekzistues):** Ky opsion nuk është i preferuar sepse në kuptim të teknikës legjislative për hartimin e tij, shumë thjesht ndryshimet janë të një natyre aq thelbësore dhe aq të mëdha sa kërkojnë ndryshime aq të thella strukturore të ligjit sa që vijimi me amendim do ta bënte ndryshimin shumë të vështirë për tu kuptuar dhe lexuar. Nëse ndiqet kjo linjë, gjithsesi do duhej menjëherë prezantimi i versionit të konsoliduar të ligjit që të ndiqej e qartë vija logjike dhe strukturore e ndryshimeve

**Opsioni 3 (Jo rregullator):** Një opsion jo rregullator do të nënkuptonte lejimin e bizneseve dhe aktorëve të tjerë të funksiononin pa një kuadër të detajuar rregullator ose me ndërhyrje minimale nga shteti, duke lejuar vetë-rregullimin dhe pajtimin vullnetar me standardet e BE-së. Ky opsion do të bënte që shoqëritë mund të operonin pa detyrime ligjore të plota për operacionet ndërkufitare, duke krijuar një mjedis më të lirë por të pasigurt për bizneset.

Megjithatë, ky opsion është i papranueshëm për Shqipërinë, pasi vendi është i detyruar të harmonizojë legjislacionin e tij me kërkesat e BE-së për integrimin në tregun e brendshëm të BE-së. Mungesa e një kuadri të detajuar rregullator do të shkaktoje pasiguri ligjore, do të dëmtonte besimin e investitorëve dhe do të dëmtonte përpjekjet për të siguruar një mjedis të drejtë dhe transparent biznesi. Po ashtu, nuk do të ishte në përputhje me angazhimet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE dhe do të krijonte një ambient të pasigurt për zhvillimin e biznesit, duke penguar mundësitë për rritjen e investimeve të huaja dhe përmirësimin e konkurrencës.

## **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)*

Zbatimi i opsioneve të politikës do të ketë ndikime të gjera ekonomike, sociale dhe institucionale. Këto ndryshime nuk do të prekin vetëm kuadrin ligjor dhe rregullator, por do të luajnë gjithashtu

një rol kyç në përmirësimin e mjedisit të biznesit në Shqipëri, rritjen e tërheqjes për investimet e huaja (FDI) dhe përshtetimin e integritit të Shqipërisë në BE. Kjo pjesë do të vlerësojë ndikimet ekonomike, sociale dhe institucionale të pritura, duke marrë parasysh si efektet afatshkurtra ashtu edhe ato afatgjata, si dhe kostot dhe përfitimet e mundshme që lidhen me secilin opsion të politikës.

Nga ana ekonomike, do të përmirësohet besimi i investitorëve dhe do të rritet tërheqja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (FDI), veçanërisht në sektorë të tillë si teknologjia dhe shërbimet, duke krijuar një mjedis biznesi më të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm. Harmonizimi me rregullat e BE-së do të lehtësojë qasjen në tregjet e brendshme të BE-së dhe do të nxisë konkurrencën. Sidoqoftë, kostot e menjëhershme të rishikimit të ligjeve dhe përditësimit të sistemeve mund të ndikojnë, por përfitimet afatgjata do t'i tejkalojnë këto kosto.

Zbatimi i këtij ligji do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi institucionet që kanë rol në regjistrimin, verifikimin, mbikëqyrjen dhe legalizimin e operacioneve ndërkufitare të shoqërive tregtare. Në radhë të parë, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) do të ketë një rol thelbësor në verifikimin dhe regjistrimin e shoqërive të huaja që transferohen në Shqipëri si rezultat i një shndërrimi, bashkimi ose ndarjeje ndërkufitare. Dhoma Kombëtare e Noterëve është një tjetër institucion që do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi projektligji parashikon që për çdo procedurë të shndërrimit ndërkufitar, të jetë i përfshirë një noter i autorizuar, i përzgjedhur nga një listë specifike e caktuar nga kjo dhomë. Gjykatat shqiptare do të kenë kompetencë për të shqyrtuar mosmarrëveshjet që lidhen me kompensimin në mjete monetare për aksionarët ose për kërkesat e kreditorëve që pretendojnë se janë prekur negativisht nga shndërrimi ndërkufitar. Ministria përgjegjëse për ekonominë do të ketë rol koordinues dhe rregullator për miratimin e formateve dhe akteve nënligjore, si dhe për dhënien e udhëzimeve teknike për zbatimin praktik të ligjit. Nga ana tjetër, pritet edhe ndikim mbi strukturat e përfaqësimit të punëmarrësve, të cilët duhet të përfshihen në organet e posaçme të negocimit në rastet kur shoqëritë që rezultojnë nga operacionet ndërkufitare do të veprojnë në Shqipëri dhe do të kenë punëmarrës nga vende të tjera të BE-së.

Në përfundim, implementimi i këtij projektligji kërkon jo vetëm burime njerëzore të kualifikuara, por edhe ngritjen e protokolleve të qarta ndërinstitucionale, rritjen e ndërveprueshmërisë digjitale ndërkombëtare, si dhe hartimin e akteve nënligjore shpjeguese dhe zbatuese në një afat të shkurtër kohor, në mënyrë që të mundësohet një zbatim i sigurt, efikas dhe në përputhje me acquis-in e BE-së.

#### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta).*

**Opsioni i preferuar është Opsioni 1- hartimi i një ligji të ri për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare.**

Ky opsion është i përshtatshëm për t'u zbatuar për arsye se:

Miratimi i një ligji të ri plotësisht të dedikuar për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare, duke shfuqizuar Ligjin nr. 110/2012. Ky opsion garanton përputhje të plotë me Direktivën (BE) 2019/2121, duke përcaktuar një herë të vetme kushtet, organet dhe rregullat e nevojshme. Ai synon të krijojë mjedis ligjor të qartë dhe të unifikuar për shoqëritë dhe palët e interesuara. Kostoja është angazhimi i konsiderueshëm institucional (trajtime, përditësim sistemesh), por kjo zgjidhje është më efektive për harmonizim të shpejtë dhe gjithëpërfshirës

Kostot buxhetore të implementimit të Opsionit 1 janë disa, por të menaxhueshme në kuadrin e strategjisë më të gjerë të integritit të Shqipërisë në BE. Investimet e nevojshme do të drejtohen kryesisht në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë programe trajnimi për profesionistët, krijimin e infrastrukturës digjitale për operacionet ndërkufitare etj..

**Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret përkatëse, si dhe duke vlerësuar secilin opsion, rezultojnë se opsioni 1 ka prioritet krahasuar me opsionet e tjera.**

**Si rezultat, vlerësojmë se opsioni më i përshtatshëm do të jetë opsioni 1.**

**Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë) është e vështirë të llogaritet me besueshmëri. Do të jetë e nevojshme të ndryshohet legjislacioni, gjë që përkthehet në kosto për ekspertët, kosto për trajnime si dhe kosto për ndërgjegjësimin e grupeve të prekura siç janë bizneset. Në fazën fillestare është e vështirë të maten kostot me besueshmëri por mund të vlerësohet se ato nuk arrijnë më shumë se 10 milionë lekë në tre vitet e para, vlerë që nuk është e rëndësishme krahasimisht me përfitimet e pritshme:**

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
10,000,000	10,000,000	10,000,000

#### **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)*

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në datën \_\_\_\_\_ me afat publikimi datën \_\_\_\_\_, me nr. shikimesh \_\_\_\_\_,

Sqarojmë se publikimi i projektligjit është bërë me titullin “ \_\_\_\_\_”, por bazuar në komentet e ardhura gjatë procesit të konsultimit me ministrinë e linjës, projektligji është ripunuar në terësi.

#### **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)*

Bazuar në projektligj, organet që parashikohen për zbatimin e nismës së propozuar janë:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Ministria përgjegjëse për financat;
- Administrata tatimore
- Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes
- Noterët
- Autoriteti i Konkurrencës

Çdo institucion do të marrë përgjegjësi për implementimin e komponentëve të caktuar të reformës, duke përfshirë trajnime për profesionistët dhe përditësimin e proceseve ligjore dhe digjitale. Monitorimi do të realizohet përmes krijimit të një mekanizmi të rregullt vlerësimi që do të analizojë progresin e zbatimit, do të identifikojë pengesat dhe do të sigurojë korrigjime të menjëhershme. Ky proces do të mbështetet me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë dhe asistencën teknike nga BE. Noterët kanë një rol kyç në bashkimet, shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare dhe duhet të verifikojnë

nëse janë respektuar të drejtat e aksionarëve, kreditorëve dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe të sigurojnë që procedurat janë në përputhje me rregullat e caktuara nga direktiva e BE-së. Ata gjithashtu mbështeten në infrastrukturën digjitale të regjistrave të shoqërive për të siguruar ndërveprueshmërinë e regjistrave të shteteve anëtare, duke kontribuar në një proces të thjeshtuar dhe transparent për shoqëritë që kryejnë operacione ndërkufitare. Shoqëritë do të duhet të sigurojnë përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës kur ato përmbushin kriteret e përcaktuara për bashkime, për të shmangur pasojat ligjore dhe financiare që mund të lindin nga mos njoftimi.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

#### *Jepni kontekstin e politikës.*

Parlamenti shqiptar miratoi në vitin 2012 Ligjin nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare”, bazuar kryesisht në Direktivat e vjetra të BE-së (2005/56/KE). Ky ligj rregullon në masë të kufizuar procedurat e bashkimit ndërkufitar, por nuk përfshin fare shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare. Direktivat e fundit të BE-së – veçanërisht Direktiva (BE) 2019/2121 – shtojnë kërkesa të reja, duke përfshirë përcaktimin e detajeve ligjore për shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare, mbrojtjen e aksionarëve që nuk bien dakord dhe të punonjësve të përfshirë . Legjislacioni aktual shqiptar nuk i pasqyron këto ndryshime, prandaj kërkohet një ligj i ri.

Legjislacioni evropian ndryshon shpesh, dhe për rrjedhojë, legjislacioni shqiptar duhet të ndjekë ritmin e zhvillimeve të reja në nivel evropian.

Në veçanti, përputhshmëria e ligjit shqiptar me Direktivën (BE) 2017/1132 lidhur me disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (kodifikim) (Direktiva e Kodifikuar), Direktivën (BE) 2019/1151 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket përdorimit të mjeteve dhe proceseve dixhitale në të drejtën e shoqërive tregtare (Direktiva për Mjetet Digjitale) dhe Direktivën (BE) 2019/2121 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare (Direktiva për Veprimtaritë Ndërkufitare), janë disa nga fushat ku Shqipëria ka ende hendeqe të dukshme.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash për të adresuar këto hendeqe dhe për të përmirësuar kuadrin ligjor të shoqërive. Në vitin 2012, Shqipëria miratoi Ligjin për Bashkimet Ndërkufitare (Ligji nr. 110/2012), i cili ka për qëllim të harmonizojë legjislacionin kombëtar me rregullat e BE-së për bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive. Sidoqoftë, disa nga ndryshimet që kërkohen, veçanërisht ato të përditësuara me Direktivën 2019/2121, ende nuk janë plotësisht të zbatuara.

Procesi i integritimit të Shqipërisë në tregun e brendshëm të BE-së kërkon që vendi të krijojë një kuadër ligjor që është i harmonizuar plotësisht me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, shumë nga këto reforma janë të mbikëqyrura nga institucionet evropiane dhe nga autoritetet shqiptare.

Sipas Raportit të Progresit 2024 të Komisionit Evropian, të publikuar më 30 tetor 2024, Shqipëria vlerësohet për përparimin në harmonizimin e legjislacionit të shoqërive tregtare me acquis-in e BE-së nën Kapitullin 6. Komisioni rekomandon intensifikimin e përpjekjeve për përafrim të plotë me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar, duke theksuar nevojën për të adresuar boshllëqet në operacionet ndërkufitare, përdorimin e mjeteve digjitale dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatim efektiv, si pjesë e negociatave për anëtarësimin<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Shih faqet 12 dhe 67 të Progress Raportit 2024.

Analiza e boshllëqeve ligjore (LGA) për Kapitullin 6 nxjerr në pah disa mangësi të rëndësishme në përafrimin e legjislacionit shqiptar me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE) 2019/1151 dhe 2019/2121. Në fushën e operacioneve ndërkufitare, situata paraqitet më komplekse: shndërrimet ndërkufitare, të trajtuara në Titullin II, Kapitulli I të ligjit shqiptar nuk janë të transpozuar sipas Direktivës 2019/2121, ndërsa bashkimet ndërkufitare, të rregulluara po në këtë kapitull, janë pjesërisht të harmonizuara përmes Ligjit nr. 110/2012, por ende kërkojnë plotësim për të përmbushur kërkesat e plota të Direktivës 2019/2121 lidhur me procedurat dhe mbrojtjen e aksionarëve, çka e rendit nivelin e përafrimit si të lartë, por jo të plotë. Ndarjet ndërkufitare, të përfshira në Titullin II, Kapitulli IV, mbeten gjithashtu të patranspozuar plotësisht sipas Direktivës 2019/2121, duke treguar mungesë të përafrimit.

Si rrjedhojë e ndërhyrjeve rregullatore dhe ligjore për përafrimin e Direktivës 2017/1132, institucionet duhet të kenë parasysh se harmonizimi me standardet e BE-së kërkon edhe disa konsiderata strategjike që duhet të ecin paralelisht me ndryshimin e Direktivës 2017/1132. Së pari, alokimi i përgjegjësive për transpozimin e këtyre kërkesave duhet të jetë i qartë dhe i koordinuar mes institucioneve kryesore si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria e Financave dhe QKB. Koordinim do të duhet në të ardhmen edhe me institucione të tjerë në kuadër të harmonizimit të kapitujve të tjerë të Acquis, ku institucioni më i ndërlidhur është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), për të siguruar që aspekte si të drejtat e aksionarëve, transparencja dhe raportimi financiar të trajtohen në mënyrë efektive dhe të unifikuar. Së dyti, mundësimi i planifikimit të përafrimit rregullator është thelbësor, duke kërkuar që ndryshimet legjislative për shoqëritë e listuara të sinkronizohen me ndërhyrjen rregullatore të kësaj RIA, për të krijuar një kuadër koherent që adreson jo vetëm kërkesat e Direktivës 2017/1132, por edhe standardet specifike të qeverisjes korporative për shoqëritë e listuara duke forcuar mbrojtjen e aksionarëve dhe transparencën në ato akte ligjore ku këto ndryshime mund të gjejnë shtratin e tyre.

Bazuar në nenin 70 të MSA-së, Shqipëria angazhohet të bëjë përafrim gradual të kuadrit të saj rregullator me acquis të BE-së, angazhim ky i ndërmarrë dhe në kuadër të negociatave të anëtarësimit në BE. Harmonizimi i legjislacionit të shoqërive tregtare me acquis respektiv të BE-së është objekt negociimi në Kapitullin 6 të negociatave “Legjislacioni i shoqërive tregtare”. Në takimin bilateral *screening*, më 3 shkurt 2023, Shqipëria shprehu angazhimin për përafrim të plotë të kuadrit të saj rregullator me acquis, ndër të tjera me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/1151 Direktiva (BE) 2019/2121, brenda vitit 2025.

Në këtë linjë vjen dhe angazhimi i qeverisë për përafrim të plotë rregullator me acquis të BE-së i cili rishprehet në Pozicionin Negociues për Kapitullin 6 të negociatave, si pjesë e Grupkapitujve 2 – Tregu i Brendshëm, ku vendi zotohet të mbyllë negociatat teknike brenda vitit 2027.

Për zbatimin e këtyre angazhimeve ligjore e politike, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027, MEKI parashikon masa për përafrimin rregullator të Direktivës së Kodifikuar, të ndryshuar, brenda vitit 2025, kjo me mbështetje të asistencës teknike ofruar nga Qeveria Gjermane, përmes GIZ.

### **Problemi në shqyrtim**

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi në shqyrtim është diferenca mes legjislacionit shqiptar dhe kërkesave të Direktivës së re. Nga studimet e RIA-së rezulton se mungesa e përafrimit ligjor pengon direkt operacionet ndërkufitare të shoqërive shqiptare. Kjo bie ndesh me parimet e BE-së për transparencë, mbrojtje të aksionarëve dhe drejtësi konkurruese. Pa ndryshime, Shqipëria do të humbiste mundësitë për të nxitur investime të huaja direkte dhe për të eliminuar burokracitë e tepërta. Mungesa e një ligji të ri mund të çojë në ndërlikime procedurale, rritje të kostove administrative për bizneset që operojnë në BE dhe rritje të rrezikut fiskal nga penalitete për mosrespektimin e rregullave të konkurrencës së BE-së. Këto probleme renditen si pika strategjike që kërkojnë ndërhyrje, duke bërë të nevojshme miratimin e rregullave të qarta dhe të unifikuara. BE ka rregulla të përbashkëta për bashkimet, ndarjet dhe shndërrimet ndërkufitare.

Në kuadër të procesit të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis-in e Bashkimit Evropian, është thelbësore të shqyrtohet se cilat janë aspektet e ligjit shqiptar që janë në përputhje të plotë me Direktivën (BE) 2017/1132, dhe cilat janë ato që kërkojnë përshtatje të mëtejshme. Kjo do të ndihmojë për të kuptuar sfidat që Shqipëria duhet të kalojë për të siguruar që ligji i saj të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e BE-së. Në këtë drejtim ka disa fusha ku ligji shqiptar ende nuk është plotësisht në përputhje me Direktivën (BE) 2017/1132. Kjo mospërputhje shkakton pasiguri ligjore për bizneset, duke kufizuar aftësinë e tyre për të operuar me efikasitet dhe transparencë, veçanërisht në transaksione ndërkufitare, dhe minon konkurrueshmërinë e tregut vendas. Për më tepër, ajo rrezikon përputhshmërinë me standardet e BE-së, duke penguar integrimin ekonomik dhe arritjen e objektivave të anëtarësimit deri në 2030, si dhe mbylljen e negociatave teknike brenda 2027-ës

### Natyra e problemit

Duke konstatuar që natyra e problemit është e karakterit rregullator, pra mungesa e përputhjes së plotë rregullatore e legjislacionit vendas me acquis-in e BE-së, evidentohen disa boshllëqe kryesore. Ligji nr. 110/2012 “Për Bashkimet Ndërkufitare të Shoqërive” nuk përafron aspak Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE) 2019/1151 dhe 2019/2121, veçanërisht për shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare dhe përafron pjesërisht atë pjesë të direktivës që rregullon bashkimet ndërkufitare.

Kjo mos përputhshmëri sjell pasiguri ligjore për bizneset dhe investitorët, duke penguar krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues. Gjithashtu, ajo rrezikon mosarritjen e objektivave për anëtarësimin në BE deri në 2030 dhe mbylljen e negociatave teknike brenda 2027-ës, duke vështirësuar integrimin e plotë të Shqipërisë në tregun e brendshëm evropian.

Shqipëria aktualisht nuk ka një kuadër të plotë dhe të përditësuar ligjor që rregullon shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare. Ligji ekzistues nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” rregullon vetëm një nga tre format e transformimeve ndërkufitare, konkretisht dhe pjesërisht bashkimet. Ky ligj nuk adreson fare ndarjen ndërkufitare, e cila për herë të parë është rregulluar në nivel të BE-së përmes Direktivës (BE) 2019/2121, dhe nuk përfshin dispozita mbi shndërrimin ndërkufitar, një procedurë gjithashtu e standardizuar nga e njëjta direktivë. Për pasojë, ekziston një boshllëk i dukshëm ligjor në lidhje me dy nga tre format kryesore të transformimeve ndërkufitare, ndërkohë që dispozitat ekzistuese për bashkimet janë të fragmentuara dhe të pa përditësuara me evoluimin e acquis-it.

Ky boshllëk krijon pasiguri juridike për shoqëritë tregtare që synojnë të ndryshojnë formën apo strukturën e tyre ligjore përmes një procesi ndërkufitar, duke kufizuar aftësinë e tyre për të transferuar regjistrimin, për të kombinuar operacionet ose për të ndarë pjesë të aktivitetit nëpërmjet kufijve shtetërorë në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të kontrolluar. Në mungesë të dispozitave të posaçme, shoqëritë shqiptare janë të penguar të përfitojnë nga fleksibiliteti i tregut të brendshëm evropian, si dhe të integrohen në mënyrë të strukturuar në zinxhirët e vlerës ndërkombëtare, përmes partneriteteve ose rindërtimeve ligjore dhe financiare.



Për më tepër, mungesa e rregullave procedurale për garantimin e të drejtave të aksionarëve, mbrojtjen e kreditorëve, transparencën ndaj punonjësve dhe kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve ndërkufitare, përbën një rrezik të shtuar për abuzime dhe shmangie ligjore, përfshirë rastet e zhvendosjes artificiale të selisë, mashtrimin për qëllime taksash, apo shkeljes së detyrimeve kontraktuale dhe sociale. Kjo përbën jo vetëm një kërcënim për parimet e sigurisë juridike dhe barazisë së trajtimit, por edhe një mospërputhje serioze me kërkesat themelore të Direktivës (BE) 2019/2121, të cilat synojnë të parandalojnë “shndërrimet abuzive” dhe të garantojnë respektimin e të drejtave të palëve të treta në proceset e transformimit ndërkufitar.

Në këtë kontekst, mungesa e një ligji të veçantë për të rregulluar në mënyrë të qartë, të unifikuar dhe të detajuar procedurat e shndërrimit, bashkimit dhe ndarjes ndërkufitare përbën një pengesë të drejtpërdrejtë për përbushjen e detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), përkatësisht nga neni 70 i saj që parashikon përafrimin progresiv të legjislacionit tregtar me *acquis-in* e BE-së, si dhe një barrierë për funksionimin e tregut të brendshëm dhe për përfitimin nga liritë themelore të tij.

Në përfundim, problemi nuk është thjesht formal apo normativ, por strukturor dhe funksional. Shqipëria nuk zotëron aktualisht një instrument të vetëm, të aksesueshëm dhe të zbatueshëm që t’u mundësojë shoqërive shqiptare dhe të huaja të realizojnë shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare në përputhje me standardet evropiane. Hartimi i një ligji të ri të posaçëm është domosdoshmëri ligjore, institucionale dhe ekonomike për të përbushur këtë boshllëk dhe për të garantuar sigurinë, konkurrencën dhe integritetin e veprimtarisë ndërkufitare të subjekteve juridike.

#### Shkaqet e problemit

Shkaqet e problemit lidhen kryesisht me mungesën e përputhshmërisë ndërmjet kërkesave të Direktivës (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/2121, dhe kornizës ekzistuese ligjore të Shqipërisë në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare, veçanërisht përsa i përket procedurave të shndërrimit, bashkimit dhe ndarjes ndërkufitare. Problemi buron nga boshllëqe të qarta ligjore dhe rregullatore, vështirësi institucionale për zbatim të efektshëm dhe mungesë të infrastrukturës procedurale dhe digjitale për trajtimin e këtyre operacioneve të ndërlikuara ndërkufitare.

Së pari, vetë kuadri legjislativ shqiptar është i paplotë dhe i vjetruar përsa i përket këtyre çështjeve. Ligji nr. 110/2012 rregullon vetëm një pjesë të kufizuar të bashkimeve ndërkufitare dhe nuk parashikon asnjë dispozitë për shndërrimin ose ndarjen ndërkufitare. Këto janë tërësisht të pambuluara nga legjislacioni aktual dhe për pasojë krijojnë boshllëqe kritike në përputhshmërinë me direktivën. Po ashtu, dispozitat për mbrojtjen e kreditorëve, transparencën ndaj punëmarrësve, të drejtat e aksionarëve për informacion dhe e drejta për të dalë nga shoqëria nuk janë të standardizuara sipas kërkesave të Direktivës 2019/2121 dhe mungojnë në tekstin e Ligjit nr. 9901/2008.

Së dyti, mungesa e një strukture të centralizuar procedurale për realizimin e operacioneve ndërkufitare, e cila të përfshijë në mënyrë të integruar përgatitjen e planeve të transformimit, verifikimin e ligjshmërisë, mbrojtjen e palëve të treta dhe ndërveprimin me regjistrat e huaj, përbën një pengesë thelbësore. Aktualisht, procedurat gjyqësore dhe administrative që mund të aplikohen në mënyrë analogjike nuk janë të harmonizuara dhe nuk ofrojnë siguri për subjektet që duan të transformohen përtej kufijve kombëtarë.

Së treti, pavarësisht ekzistencës së një infrastrukture për regjistrimin elektronik të subjekteve tregtare, Shqipëria nuk ka integruar ende sistemin e ndërlidhjes me regjistrat e vendeve të BE-së (BRIS), i cili është një kërkesë teknike e domosdoshme për të zbatuar në praktikë procedurat e miratimit dhe regjistrimit ndërkufitar. Megjithatë kjo ndërhyrje do të realizohet duke përditësuar legjislacionin për regjistrimin e biznesit si pjesë e po kësaj pakete ndërhyrjesh ligjore dhe rregullatorë. QKB funksionon në mënyrë digjitale në nivel kombëtar, por nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të përbushur kërkesat e ndërlidhjes ndërkombëtare të të dhënave dhe verifikimit në kohë reale të ekzistencës, statusit dhe të dhënave të shoqërive partnere.

Së katërti, aktualisht mungojnë akte nënligjore, udhëzime ose protokolle zbatimi që të mundësojnë përfshirjen e noterëve, gjykatave, QKB-së dhe strukturave të mbrojtjes së punëmarrësve në një mekanizëm

të unifikuar për kontrollin e ligjshmërisë dhe zbatimin e të drejtave të palëve në këto lloj transformimesh. Kjo bën që edhe në rastet e aplikueshme, zbatimi të jetë fragmentar, joefektiv dhe i pambështetur në kapacitete të strukturuar.

Edhe pse mbrojtja e punëmarrësve nuk është objekt i drejtpërdrejtë i këtij projektligji, duhet theksuar se sipas kërkesave të acquis-it dhe në kuadër të negociatave të Kapitullit 19, Shqipëria do të duhet të përmbushë në një moment të dytë detyrimet që burojnë nga Direktiva 2001/23/KE, e cila kërkon ruajtjen e të drejtave të punonjësve në rastet e transferimit të ndërmarrjeve ose pjesëve të tyre. Aktualisht, pjesa më e madhe e kësaj direktive është vetëm pjesërisht e reflektuar në Kodin e Punës, dhe mungesa e një ndërveprimi sistematik ndërmjet të drejtës së punës dhe të drejtës së shoqërive mund të përbëjë një problem gjatë implementimit të transformimeve ndërkufitare në praktikë.

Përmbledhtas, shkaku themelor i problemit që ky projektligj synon të adresojë është mungesa e një kuadri të vetë qëndrueshëm, të plotë dhe të përputhshëm me BE-në për trajtimin e procedurave ndërkufitare të transformimeve të shoqërive. Vetëm një ligj i ri, me strukturë të pavarur dhe të përqendruar, mund të ofrojë zgjidhje efektive, të qëndrueshme dhe të përafëruara me acquis-in në këtë fushë.

### Shtirja e problemit

Problemi ka një shtirje të gjerë, duke prekur të gjitha ato shoqëri tregtare në Shqipëri që potencialisht mund të përfshihen në operacione ndërkufitare. Sipas raportit të INSTAT për 2023, nga 226,778 njësitë ligjore aktive, 28,292 SHPK dhe 716 SHA mund të ndikohen drejtpërdrejt nga mungesa e harmonizimit, ndërsa 5.3% e ndërmarrjeve me kapital të huaj (rreth 6,900 entitete) përballen me pengesa në transaksione ndërkufitare, për shembull, vonesa në regjistrimin e bashkimeve për shkak të mungesës së ndërveprueshmërisë me BRIS-in. Kjo situatë sjell pasoja ekonomike të rëndësishme, duke përfshirë reduktimin e investimeve të huaja për shkak të pasigurisë ligjore dhe rritjen e barrës administrative për bizneset, sidomos NVM-të, të cilat përbëjnë 86.2% të ndërmarrjeve aktive dhe vuajnë nga kosto shtesë për përshtatje me standarde të paplot.

Për të siguruar harmonizimin e plotë me Direktiva 2017/1132 dhe për të adresuar çështjet e ngritura, ndërhyrjet rregullatore duhet të bëhen në një masë të plotë që siguron harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar me kërkesat e BE-së. Përshtatjet duhet të bëhen duke realizuar një ndërhyrje e plotë për të pasqyruar dispozitat për bashkimet, shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare. Ky harmonizim duhet të përfshijë rregullat e reja për mbrojtjen e interesave të aksionarëve, punonjësve dhe kreditorëve, si dhe procedurat dhe formalitetet për realizimin e këtyre transaksioneve ndërkufitare. Duhet të përshtaten rregullat për mbrojtjen e aksionarëve që nuk janë dakord me bashkimin dhe për rregullat për mbrojtjen nga abuzimi dhe mashtrimi.

Në përgjithësi, ndërhyrjet duhet të bëhen në një masë të plotë që i mundëson Shqipërisë të përmbushë plotësisht kërkesat e BE-së, duke i sjellë ato në legjislacionin aktual, pa krijuar ndryshime të panevojshme të strukturës ligjore të vendit. Ky proces duhet të përfshijë konsultime të vazhdueshme me aktorët e përfshirë, duke siguruar që legjislacioni të jetë funksional dhe në përputhje me kërkesat e BE-së për transparencë, siguri dhe mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

### Grupet kryesore që preken nga ky problem janë:

Grupet kryesore të prekura nga mungesa e harmonizimit me Direktivën (BE) 2017/1132 mund të grupohen si më poshtë për të pasqyruar ndikimin e gjerë të këtij problemi.

**Së pari, institucionet shtetërore** – përfshirë Ministrinë përgjegjëse për Ekonominë (MEKI), Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), Dhomën Kombëtare të Noterisë, Ministrinë e Drejtësisë, si dhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm – preken nga nevoja për të garantuar implementimin efektiv të dispozitave procedurale dhe materiale për operacionet ndërkufitare. QKB duhet të përditësojë sistemet digjitale dhe të përgatitet për ndërveprimin me sistemin e ndërlidhjes së regjistrave të BE-së (BRIS), ndërkohë që Dhomës

së Noterisë i kërkohet të krijojë dhe mirëmbajë një listë të noterëve të certifikuar për kontrollin e ligjshmërisë së operacioneve ndërkufitare. Gjykatat do të pajisen me kompetenca për vlerësimin e kërkesave të kreditorëve dhe aksionarëve që kundërshtojnë një transformim, si dhe për dhënien e kompensimeve.

**Së dyti, shoqëritë tregtare**, veçanërisht ato që operojnë në tregje ndërkombëtare ose që planifikojnë të realizojnë transformime strategjike, janë grupi kryesor ekonomik që preket nga ky boshllëk ligjor. Mungesa e rregullave të qarta për shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare ndalon ose ngadalëson procese që përndryshe do të ishin legjitime dhe strategjiksht të nevojshme për ristrukturimin e tyre. Ndikimi është më i madh për shoqëritë aksionare dhe ato me kapital të përbashkët ndërkombëtar, të cilat kërkojnë siguri procedurale, parashikueshmëri dhe garanci mbrojtjeje të palëve të treta. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2023, nga 226,778 njësi ligjore aktive në Shqipëri, rreth 5.3% kanë kapital të huaj ose janë ndërmarrje të përbashkëta, me përqendrim të veçantë në Tiranë, Durrës dhe Vlorë – rajone që pritet të ndiejnë më shumë ndikimin e reformës.

**Së treti, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të)** përbëjnë pjesën dërrmuese të subjekteve ekonomike në vend dhe megjithëse përfshihen më rrallë në operacione ndërkufitare, ato preken nga mungesa e një mjedisi të qartë rregullator dhe nga kufizimi i mundësisë për të hyrë në partneritete me investitorë të huaj ose për të realizuar ndarje strategjike në tregje të tjera. Një kuadër i paqartë ligjor ndikon negativisht në besueshmërinë e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe në aftësinë për të aksesuar forma alternative financimi ose ristrukturimi.

**Së katërti, noterët** Direktiva 2005/56/KE, e cila trajtonte bashkimet ndërkufitare, është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga Direktiva 2017/1132 (Direktiva e Kodifikuar), veçanërisht nga dispozitat që lidhen me shndërrimet ndërkufitare, bashkimet dhe ndarjet. Ndryshimet kyçe që ndikojnë tek noterët në kontekstin e Direktives 2017/1132 lidhen me thjeshtimin e procedurave dhe futjen e rregullave më të qarta për implementimin e operacioneve ndërkufitare, duke përfshirë bashkimet dhe ndarjet. Edhe pse Direktiva origjinale kërkonte një proces certifikimi nga një autoritet (duke përfshirë noterët), Direktiva e Kodifikuar, në Recitalet 25 dhe 26, konsolidon këto kërkesa dhe përqendrohet në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë në këto procese, duke siguruar që ato të jenë të qarta, transparente dhe në përputhje me standardet e BE-së.

Për noterët, ndikimi kryesor lidhet me rolin e tyre në procesin e verifikimit për operacionet ndërkufitare si bashkimet dhe shndërrimet. Noterët kanë detyrën të sigurojnë që kërkesat ligjore të shtetit të anëtarit të jenë plotësuar përpara regjistrimit në rastin e bashkimeve ose shndërrimeve. Kjo përfshin kontrollin e sa janë respektuar të drejtat e aksionarëve dhe të kreditorëve. Noterët gjithashtu duhet të sigurojnë që dokumentet e nevojshme të dorëzohen dhe të certifikohen për të vazhduar me regjistrimin. Gjithashtu, sipas direktivës së kodifikuar, mbetet kërkesa për noterët që të sigurojnë dokumentacionin e duhur dhe të konfirmojnë përputhshmërinë ligjore përpara regjistrimit. Megjithatë, ka një theks të shtuar në sigurinë që procedurat janë të efektshme dhe të harmonizuara me sistemet ndërkufitare të regjistrave, që do të përmirësojnë bashkëpunimin dhe transparencën ndërmjet shteteve anëtare. Kjo mund të kërkojë që noterët të përshtatin praktikatat e tyre për t'iu përshtatur infrastrukturës digjitale të sistemeve të ndërlidhur për regjistrat e shoqërive në BE. Ndikimi rregullator për noterët është kryesisht i lidhur me këto përshtatje procedurale, duke siguruar përputhshmërinë me kuadrin e ri ligjor të BE-së dhe duke kontribuar në një proces më të thjeshtë dhe efikas për shoqëritë që angazhohen në operacione ndërkufitare brenda BE-së.

**Së pesti**, një tjetër ndikim vlerësohet për qëllime të konkurrencës, veçanërisht për transaksionet e bashkimeve dhe blerjeve. Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar parashikon se, nëse shoqëritë e bashkuara përmëshin nivelet e xhirove apo nivelet e tjera të caktuara në lidhje me pjesën e tregut dhe të ardhurat, ato duhet të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës për miratimin e transaksionit. Autoriteti do të vlerësojë ndikimin e bashkimit në konkurrencë, duke u fokusuar te mundësia që ky bashkim të krijojë ose forcojë një pozicion dominues që mund të prishë konkurrencën në treg. Këto rregulla do të ndikojnë jo vetëm te shoqëritë që operojnë brenda tregut të brendshëm, por edhe te ato që janë të përfshira në operacione ndërkufitare, duke kërkuar që të përputhen me kërkesat e bashkimit dhe konkurrencës të harmonizuara me rregullat e BE-së. Kjo do të kërkojë që shoqëritë të sigurojnë

përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës kur ato përmbushin kriteret e përcaktuara për bashkime, për të shmangur pasojat ligjore dhe financiare që mund të lindin nga mosnjoftimi.

**Së gjashti, qytetarët dhe sipërmarrësit e rinj** janë gjithashtu të prekur në mënyrë të tërthortë, pasi mungesa e një rruge të ligjshme dhe të thjeshtuar për të transformuar një subjekt në një juridiksion tjetër ose për të bashkuar një njësi ekzistuese me një shoqëri të huaj, kufizon mundësitë për ndërkombëtarizim dhe për zgjerim në tregjet e BE-së. Për më tepër, individët përballen me mungesën e informacionit të standardizuar dhe mjeteve të aksesueshme digjitale që do t'i ndihmonin në orientimin në këto procedura.

**Së shtati, shoqatat e biznesit dhe shoqëria civile**, të cilat kanë rol në ndërmjetësimin e interesave dhe në mbështetjen me asistencë ligjore dhe teknike për bizneset, janë penguar nga mungesa e një baze ligjore të harmonizuar. Këto organizata kanë potencial për të qenë faktorë kyç në zbatimin e reformës, por për momentin operojnë në një mjedis të fragmentuar dhe jo të harmonizuar përsa i përket legjislacionit të transformimeve ndërkufitare.

Në lidhje me aktivitetet ndërkufitare, ndërmarrjet me kapital të huaj dhe të përbashkëta përbëjnë 5.3% të ndërmarrjeve aktive, me 63.1% të këtyre që kanë origjinë nga Europa. Pjesa më e madhe e këtyre ndërmarrjeve është e përqendruar në Tiranë, Durrës dhe Vlorë, që mbajnë një pjesë të përbashkët prej 65.6% të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

Duke marrë parasysh këto statistika, ndryshimet që do të vendosen për harmonizimin e ligjit shqiptar me Direktivën 2017/1132 do të prekin të gjitha shoqëritë, veçanërisht ato që janë angazhuar në operacione ndërkufitare. Shoqëritë do të duhet të përditësojnë statutet dhe dokumentet e tyre organizative për të siguruar që ato përputhen me kërkesat e reja. Ato do të duhet të zbatojnë masa shtesë transparence në lidhje me të drejtat e aksionarëve dhe qeverisjen korporative.

#### Vlerësimi i mundësisë për të trajtuar problemin përmes një ndryshimi të politikave

Ky problem mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave, veçanërisht duke miratuar një ligj të ri që do të adresojë boshllëqet ligjore ekzistuese dhe do të krijojnë një mjedis ligjor të harmonizuar plotësisht me standardet e BE-së, detyrim ky sipas nenit 70 të MSA-së. Prandaj, trajtimi i këtij problemi kërkon domosdoshmërisht ndërhyrje rregullatore, si e vetmja mënyrë për të adresuar natyrën e tij dhe për të arritur harmonizimin me standardet e BE-së. Ndryshimi rregullator është i nevojshëm në dy drejtime kryesore. Së pari, politikisht, ai përfaqëson një angazhim të marrë në kuadër të negociatave të anëtarësimit në BE, ku përafrimi me *acquis-in*, përfshirë Direktivën (BE) 2017/1132, është një prioritet për mbylljen e Kapitullit 6 dhe avancimin e procesit të integritimit. Së dyti, ligjërisht, ky ndryshim rrjedh nga detyrimet e përcaktuara në Nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), e cila angazhon Shqipërinë për të harmonizuar gradualisht legjislacionin vendas me atë të BE-së.

Megjithatë, masa të tjera plotësuese jorregullatore mund të mbështesin këtë proces, pa mundur të zëvendësojnë ndërhyrjen rregullatore. Për shembull, organizimi i trajnimeve për profesionistët ligjorë dhe punonjësit e institucioneve si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) apo MEKI-t mund të rrisë kapacitetet për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat komplekse të Direktivës. Po ashtu, ofrimi i mbështetjes teknike dhe programeve trajnuese për bizneset dhe zyrtarët mund të lehtësojë përshtatjen me rregullat e reja dhe të përshejtojë zbatimin praktik të reformave. Fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), mund të rrisin njohuritë për përfitimet e një kuadri ligjor të harmonizuar. Konsultimet me palët e interesuara, si shoqatat e biznesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave specifike dhe në përshtatjen e zbatimit të rregullave të reja për të minimizuar sfidat praktike, duke krijuar një proces më gjithëpërfshirës dhe të mbështetur. Gjithashtu, ofrimi i asistencës teknike përmes bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë si GIZ ose institucione të BE së mund të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës digjitale të QKB-së dhe përmirësimin e aftësive administrative për të plotësuar standardet teknike të ndërlidhjes me sistemin BRIS.

Këto masa, ndonëse të dobishme për të adresuar sfidat e mbetura dhe për të përmirësuar efikasitetin, mbeten dytësore dhe nuk mund të kompensojnë mungesën e një kuadri ligjor të plotë dhe të zbatueshëm, i cili mbetet thelbësor për zgjidhjen përfundimtare të problemit..

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

6. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
7. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
8. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
9. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

### **Arsyeja për Ndërhyrje**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë vlerëson se ndërhyrja legislative përmes miratimit të një ligji të ri për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare është e domosdoshme për të mbushur një boshllëk kritik në kuadrin juridik kombëtar dhe për të siguruar përputhshmëri të plotë me Direktivën (BE) 2019/2121, e cila ka standardizuar procedurat e transformimeve ndërkufitare në nivel të BE-së duke zëvendësuar qasjet kombëtare të fragmentuara. Shqipëria nuk ka aktualisht asnjë dispozitë në fuqi që të rregullojë shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare, dhe ligji ekzistues për bashkimet ndërkufitare (Ligji nr. 110/2012) është i kufizuar dhe i vjetëruar, pasi pasqyron vetëm direktivën e mëparshme 2005/56/KE tashmë të shfuqizuar.

Ndërhyrja bëhet veçanërisht e domosdoshme në kontekstin e procesit të negociatave të anëtarësimit në BE, konkretisht për Kapitullin 6 – E drejta e shoqërive, ku Shqipëria ka për detyrë të arrijë përputhshmëri të plotë me *acquis-in* e BE-së deri në vitin 2027 dhe të jetë e gatshme për integrim të plotë në tregun e brendshëm deri në vitin 2030, siç përcaktohet në Pozicionin Negociues për Kapitullin 6 (janar 2025) dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030. Kjo ndërhyrje nuk është thjesht një detyrim teknik, por një hap i domosdoshëm strategjik për të siguruar siguri juridike, parashikueshmëri procedurale, transparencë tregtare, dhe për të krijuar kushte të barabarta për shoqëritë shqiptare që synojnë të operojnë përtej kufijve kombëtarë.

### Çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Qeveria synon të adresojë pesë problematika themelore përmes miratimit të këtij ligji të ri:

1. Mungesën e dispozitave procedurale për shndërrimet ndërkufitare, të cilat aktualisht nuk janë të rregulluara në mënyrë të qartë, duke penguar aftësinë e shoqërive shqiptare për të realizuar shndërrime, bashkime ose ndarje me partnerë të huaj në përputhje me standardet e BE-së.
2. Pasigurinë juridike që rezulton nga mungesa e mbrojtjes së kreditorëve, të drejtave të aksionarëve pakicë, dhe përfshirjes së punëmarrësve në operacionet ndërkufitare, siç kërkohet nga direktiva.
3. Mungesën e autoriteteve të verifikimit të ligjshmërisë, që është një kërkesë eksplicite e direktivës, e cila parashikon që çdo shtet anëtar të caktojë një organ (p.sh. noterë ose gjykata) për të certifikuar përputhshmërinë para regjistrimit të transformimeve ndërkufitare.
4. Nevojën për një mekanizëm të standardizuar komunikimi ndërmjet regjistrave tregtarë, i cili përmes BRIS do të mundësojë verifikimin dhe regjistrimin ndërkufitar në mënyrë të sinkronizuar.
5. Nevojën për të siguruar një nivel të ri të transparencës dhe llogaridhënies përmes planeve të transformimit, raporteve të administratorëve dhe aksesit të gjerë publik në dokumentacionin e depozituar.

Ligji i ri synon t'i japë fund trajtimit të fragmentuar të këtyre çështjeve dhe të ofrojë një instrument të vetëm, të harmonizuar dhe të qasshëm, për të lehtësuar transformimet ndërkufitare dhe për të përgatitur Shqipërinë për pjesëmarrje aktive në tregun e brendshëm të BE-së.

### Si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues për zhvillimin ekonomik. Harmonizimi është një hap kyç për të siguruar që Shqipëria të përmbushë kriteret e kërkuara për anëtarësim në BE dhe për të rritur pozicionin e saj në tregjet ndërkombëtare. Harmonizimi realizohet duke u mbështetur në disa dokumente strategjike kyçe:

- **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA):** Sipas Nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me atë të BE-së. Kjo ndërhyrje rregullore plotëson këtë kërkesë duke harmonizuar legjislacionin e shoqërive tregtare me Direktivën (BE) 2017/1132, duke forcuar kështu bazën ligjore për anëtarësimin në BE.
- **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027:** Harmonizimi me *acquis*-in e BE-së është një prioritet i përcaktuar në PKIE, veçanërisht për mbylljen e Kapitullit 6 të negociatave me BE brenda vitit 2027. Kjo ndërhyrje është një hap konkret drejt përmbushjes së këtij objekti, duke avancuar negociatat teknike dhe përgatitjen për tregun e brendshëm evropian.
- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2030:** Kjo ndërhyrje mbështet vizionin afatgjatë të SKZHI 2030 për anëtarësimin e Shqipërisë në BE deri në vitin 2030. Duke përafuar standardet rregullore me ato të BE-së, ajo siguron që vendi të jetë i gatshëm për integrimin e plotë në tregun evropian, duke kontribuar në stabilitetin dhe prosperitetin ekonomik.
- **Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2025-2030:** Sipas këtij dokumenti, të hartuar në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndërhyrja rregullore përkon me qëllimin për të stimuluar rritjen e ekosistemit të startup-eve dhe për të zhvilluar sektorët me prioritet ekonomik si turizmi, energjia, bujqësia dhe ICT/BPO. Kjo strategji synon të rrisë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e këtyre sektorëve duke mbështetur sipërmarrjen inovative, dhe harmonizimi i ligjit të shoqërive tregtare me BE-në—përfshirë modernizimin digjital dhe operacionet ndërkufitare—fuqizon bizneset shqiptare për të çelur tregje të reja dhe për të konkurruar në nivel ndërkombëtar, duke përshpejtuar rrugëtimin drejt BE-së 2030.
- **Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (BIDS):** Në linjë me objektivat e saj për të përmirësuar klimën e biznesit, kjo ndërhyrje nxit zhvillimin e sektorit privat përmes forcimit të qeverisjes korporative dhe mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve, duke e bërë Shqipërinë më tërheqëse për investime të huaja të drejtpërdrejta dhe duke mbështetur rritjen ekonomike.

Duke harmonizuar legjislacionin shqiptar me standardet e BE-së, kjo ndërhyrje jo vetëm që përmbush kërkesat për integrim evropian, por edhe krijon mundësi të reja për investime dhe inovacion, veçanërisht për startup-et dhe sektorët strategjikë të identifikuar në Strategjinë e Sipërmarrjes Inovative. Ajo rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare duke lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe duke forcuar stabilitetin ekonomik, në përputhje të plotë me prioritetet e qeverisë për zhvillim dhe integrim afatgjatë.

#### Punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Në kuadër të përpjekjeve për harmonizimin me *acquis*-in e BE-së për Kapitullin 6, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në bashkëpunim me Grupin Negociator të Integritimit Evropian, ka ndërmarrë punë të rëndësishme për të avancuar procesin e harmonizimit të legjislacionit të shoqërive tregtare, duke u mbështetur në analizat e detajuara si Vlerësimi i Boshllëqeve Legjislative (LGA), Vlerësimi i Boshllëqeve Institucionale dhe Administrative (IAGA), dhe Vlerësimi i Ndikimit të Politikave (PIA) për Qeverisjen Korporative të Shoqërive të Listuara.

**LGA:** LGA-ja, identifikon boshllëqe mes legjislacionit shqiptar dhe Direktivës 2017/1132, duke treguar përafrim të mirë por mangësi në çështjet e përmendura përgjatë kësaj RIA, si dhe nevojën për harmonizim të plotë, duke propozuar ndërhyrje legjislative për përmbushjen e standardeve të BE-së.

**IAGA:** IAGA-ja thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për interpretimin, transpozimin, zbatimin dhe monitorimin e ligjit të BE-së për shoqëritë, duke përfshirë krijimin e kushteve për formimin online të shoqërive, përmirësimin e funksionalitetit të regjistrimit kombëtar, dhe trajnimet për institucionet, si dhe pavarësinë financiare të organeve të mbikëqyrjes së auditimit, duke ofruar një udhërrëfyes për zbatimin efektiv të acquis-it.

**Vlerësimi i Ndikimit të Politikave (PIA):** i hartuar nga MEKI dhe GNIE, ofron një analizë ndërsektoriale të çështjeve të Kapitullit 6, duke u fokusuar në harmonizimin e qeverisjes korporative për shoqëritë e listuara me acquis-in e BE-së, si Direktiva 2007/36/EC (SRD I), Direktiva 2017/828 (SRD II), dhe Direktiva 2022/2381 për balancën gjinore në bordet e shoqërive të listuara. PIA identifikon boshllëqe në legjislacionin shqiptar, si mungesa e rregullave për ndërmjetësit financiarë dhe politikat e angazhimit të aksionarëve, dhe propozon opsione si amendimi i Ligjit për Tregjet e Kapitalit dhe miratimi i një Kodi të Qeverisjes Korporative për shoqëritë e listuara deri në 2028, duke përfshirë institucionet si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) Ky dokument plotëson LGA-në dhe IAGA-në duke ofruar një analizë specifike për shoqëritë e listuara, duke evidentuar nevojën për koordinim mes MEKI dhe AMF-së për të adresuar mangësitë e identifikuara. PIA gjithashtu vlerëson ndikimet ekonomike dhe administrative, duke theksuar përfitimet për konkurrueshmërinë dhe investimet e huaja, dhe propozon një udhërrëfyes me afate për harmonizim deri në 2025-2028.

### **Objektivi i politikës**

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi themelor i kësaj ndërhyrjeje është krijimi i një kuadri të ri ligjor të posaçëm i cili siguron transpozimin e plotë, të qartë dhe të zbatueshëm të dispozitave të Direktivës (BE) 2019/2121 në lidhje me shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare. Qëllimi është të përmbushet angazhimi i Shqipërisë për harmonizim të plotë me acquis-in e BE-së në fushën e të drejtës së shoqërive, në kuadër të mbylljes së negociatave për Kapitullin 6 brenda vitit 2027 dhe integritet në tregun e përbashkët evropian deri në vitin 2030, siç parashikohet në dokumentet kombëtare strategjike dhe pozicionet negociuese zyrtare.

Ky objektivi mbështet transformimin e kuadrit normativ shqiptar nga një sistem i pjesshëm dhe i fragmentuar në një arkitekturë të integruar, të përputhshme dhe funksionale, që i mundëson shoqërive shqiptare të kryejnë operacione ndërkufitare me të njëjtat garanci dhe standarde ligjore si shoqëritë në shtetet anëtare të BE-së. Në mënyrë të veçantë, ky objektivi përfshin:

- Krijimin e një baze procedurale për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare, përfshirë rregulla të detajuara për planifikimin, transparencën, mbrojtjen e palëve të treta dhe përfundimin e procedurës me efekt juridik të drejtpërdrejtë në regjistrin kombëtar;
- Garantimin e të drejtave të kreditorëve, punëmarrësve dhe aksionarëve të pakicës, duke siguruar që çdo transformim të mos shkelë parimet e barazisë, përfaqësimit dhe aksesit në drejtësi;
- Zbatimin e rolit të autoritetit të kontrollit të ligjshmërisë (p.sh. noterit ose një organi tjetër të caktuar), si parakusht për lëshimin e certifikatës së miratimit për transformimet ndërkufitare;

Përmirësimin e ndërveprueshmërisë ndërmjet regjistrave tregtarë, përmes krijimit të kushteve për zbatimin e standardeve teknike të BRIS (në përputhje me Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) 2021/1042),

me qëllim që të mundësohet verifikimi, shkëmbimi dhe regjistrimi ndërkufitar në mënyrë të sigurt dhe të sinkronizuar.

### Sigurimi që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë

Në zbatim të qëllimit të përgjithshëm të ndërhyrjes, politikë bëra synon arritjen e objektivave të mëposhtëm deri në fund të vitit 2027:

1. Transpozimi integral dhe i drejtpërdrejtë i Direktivës (BE) 2019/212, përmes një ligji të ri të posaçëm, i cili zëvendëson Ligjin nr. 110/2012 dhe unifikon procedurat e shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare në një instrument të vetëm juridik.
2. Aktivizimi i autoritetit të kontrollit të ligjshmërisë (në formën e noterëve të specializuar ose një autoriteti tjetër të përzgjedhur) dhe krijimi i regjistrimit përkatës të autorizimeve dhe trajnimeve profesionale brenda vitit 2026, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.
3. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore shoqëruese, përfshirë modelet e planeve të transformimit, raportet standarde të administratorëve, procedurat e njoftimit dhe afatet e kundërshtimit, me afat zbatimi jo më vonë se tremujori i parë i vitit 2026.
4. Ndërtimi i ndërveprueshmërisë teknike me BRIS, përmes përafrimit të sistemit të Qendrës Kombëtare të Biznesit me standardet e Rregullores së Zbatimit (BE) 2021/1042, për të mundësuar komunikimin midis regjistrave dhe ndarjen e të dhënave për operacionet ndërkufitare brenda vitit 2027.
5. Krijimi i moduleve të posaçme digjitale në QKB, që lejojnë gjurmueshmërinë e operacioneve ndërkufitare dhe depozitimin online të dokumentacionit shoqëruës, në përputhje me kërkesat e direktivës dhe praktikat e shteteve anëtare.
6. Rritja e transparencës dhe e aksesit publik në informacion, duke siguruar që të gjitha certifikatat e miratimit, dokumentet e transformimit dhe aktet e regjistrimit të jenë të publikuara në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme në format elektronik, jo më vonë se fundi i vitit 2026.

---

### Objektiva të lidhura me rezultatet afatgjata

- Lehtësimi i integritetit të shoqërive shqiptare në tregun e brendshëm të BE-së, përmes rregullave që shmangin pasigurinë juridike dhe abuzimet procedurale (në përputhje me Recitalin 6 të Direktivës).
- Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe rritja e atraktivitetit për investimet e huaja, përmes garantimit të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe strukturave të korporatave ndërkufitare.

### **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

**Opsioni 0 (status quo)-** nënkupton vijimin me kuadrin aktual ligjor, konkretisht me Ligjin nr. 110/2012, i cili rregullon vetëm pjesërisht bashkimet ndërkufitare sipas standardeve të mëparshme të Direktivës 2005/56/EC. Ky opsion nënkupton mosmiratimin e një ligji të ri dhe mbajtjen në fuqi të ligjit ekzistues, pa përfshirë dispozita për ndarjet dhe shndërrimet ndërkufitare dhe pa reflektuar mekanizmat mbrojtës për palët e treta, punonjësit dhe aksionarët kundërshtues siç kërkohet nga Direktivës 2019/2121. Ky opsion është i pamundur për t'u zbatuar, pasi Shqipëria, si shtet kandidat për në Bashkimin Evropian, është e



detyruar të përafrojë plotësisht legjislacionin e saj kombëtar me *acquis-in* e BE-së, në përputhje me nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe angazhimet e marra në kuadër të Kapitullit 6. Nëse status quo-ja ruhet, Shqipëria do të mbetet në mospërputhje me standardet minimale të Bashkimit Evropian, duke e pamundësuar mbylljen e negociatave për Kapitullin 6 dhe duke dëmtuar reputacionin e saj si vend reformues në fushën e të drejtës tregtare.

**Opsioni 1** –(Miratimi i një ligji të ri të posaçëm për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare – opsioni i preferuar) konsiston në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri, të veçantë, që transponon në mënyrë të plotë pjesën përkatëse të Direktivës (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/2121, që rregullon shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive. Ky opsion zëvendëson Ligjin nr. 110/2012 me një ligj tërësisht të ri duke siguruar koherencë të brendshme dhe përputhshmëri të drejtpërdrejtë me tekstin e direktivës. Kjo qasje u zgjodh pas një analize të detajuar të boshllëqeve të konstatuara në legjislacionin ekzistues, përmes metodologjisë së përkufizuar në LGA dhe IAGA të vitit 2024.

Ky opsion përjashton ndërhyrjen në ligje të tjera të karakterit të përgjithshëm si Ligji nr. 9901/2008 apo Ligji nr. 9723/2007 dhe fokusohet vetëm në krijimin e një akti të veçantë horizontal, i cili mund të zbatohet paralelisht me dispozitat e ligjeve të tjera kur bëhet fjalë për operacione ndërkufitare. Kjo zgjedhje u vlerësua si më e përshtatshme, për shkak se lejon përafrim të drejtpërdrejtë dispozitë për dispozitë, nuk ngatërron sistematikën e ligjeve ekzistuese dhe ofron siguri juridike për subjektet që duan të kryejnë operacione ndërkufitare në përputhje me standardet e BE-së. Ligji i ri do të përmbajë rregullime të hollësishme mbi mbrojtjen e kreditorëve dhe aksionarëve, mbi kontrollin *ex ante* dhe *ex post* nga gjykatat ose organet administrative dhe do të përcaktojë mekanizmat për shmangien e abuzimeve dhe shmangies nga ligji për qëllime të paarsyeshme tatimore apo për të cenuar të drejtat e palëve të treta.

**Opsioni 2 ((Integrimi i dispozitave në ligjet ekzistuese përmes amendimeve të pjesshme)** parashikon përfshirjen e dispozitave të Direktivës (BE) 2019/2121 për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare brenda strukturës së ligjeve ekzistuese, duke amenduar në mënyrë të fragmentuar Ligjin nr. 9901/2008 dhe Ligjin nr. 110/2012. Megjithatë ky opsion ishte i diskutuar në fazat paraprake të analizës, ai u konsiderua më pak efikas për shkak të ngarkesës sistematike që do t'i shkaktonte ligjeve ekzistuese, vështirësisë në ndarjen e qartë të operacioneve ndërkombëtare nga ato të brendshme dhe potencialit për pasiguri juridike dhe mbivendosje normash. Për më tepër, kjo zgjidhje nuk do të mundësonte ndërtimin e një arkitekture të qartë të ligjit as nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe as nga ana praktike duke qenë se ndryshimet që sjell përafrimi janë disa herë më të mëdha në volum dhe përmbajtje sesa përmbajtja ekzistuese e ligjit. Kjo do të kërkonte ndryshime aq thelbësore strukturore se arkitektura ekzistuese e ligjit nuk i akomodon dot pa prishur vetë strukturën ekzistuese, çka shkon ndesh me standardet e hartimit të legjislacionit në Shqipëri.

### **Opsioni 3 (Jo rregullator)**

Një qasje jo rregullatore do të nënkuptonte lejimin e bizneseve dhe aktorëve të tjerë relevantë të funksionojnë pa një kuadër të detajuar rregullator ose me ndërhyrje minimale nga shteti. Në këtë opsion, bizneset do të kishin lirinë për të vetë-rregulluar dhe për t'u pajtuar vullnetarisht me standardet bazë të BE-së, pa asnjë detyrim ligjor për të zbatuar rregulla të detajuara që lidhen me operacionet ndërkufitare ose qeverisjen korporative të tyre.

Ky opsion jo rregullator nuk mund të konsiderohet si një mundësi e vlefshme për Shqipërinë për disa arsye:

1. Si një shtet kandidat për në BE, dhe në zbatim të nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar ligjërisht të harmonizojë legjislacionin e saj kombëtar me rregulloret e BE-së si pjesë e procesit të integritimit në BE. Bashkimi Evropian ka vendosur një kuadër rregullator të detyrueshëm, në të cilin shtetet anëtare duhet të funksionojnë, veçanërisht në fushat e operacioneve ndërkufitare dhe qeverisjes korporative. Mospajtueshmëria me këto rregullore do të minonte procesin e integritimit të Shqipërisë dhe do ta shtynte më tej anëtarësimin e saj në BE.
2. Mungesa e një kuadri të qartë rregullator do të krijonte pasiguri të konsiderueshme për investitorët, bizneset dhe aktorët relevantë. Pa një grup të rregullave të detajuara në vend, Shqipëria nuk do të

mund të garantojë mbrojtjen e investimeve, funksionimin e duhur të tregut të brendshëm dhe konkurrencën e drejtë. Bizneset nuk do të kishin sigurinë se investimet e tyre janë të mbrojtura. Ky skenar do të çonte në tërheqjen e pakët të investimeve të huaja, të cilat janë thelbësore për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

3. Bashkimi Evropian kërkon masa specifike për të mbrojtur interesat e palëve të interesuara, për të siguruar transparencë dhe për të promovuar praktika të drejta biznesi. Një qasje jo rregullore do të injoronte këto kërkesa dhe do të lënte Shqipërinë jashtë përputhshmërisë me BE-në. Një situatë e tillë do të pengonte Shqipërinë të merrte pjesë plotësisht në tregun e brendshëm të BE-së dhe mund të rezultonte në sanksione ose barriera tregtare me shtetet anëtare të BE-së.
4. Nëse do të lihen shoqëritë dhe institucionet të vetë-rregullohen, do të ketë një rrezik të madh për praktika të pasqaruara, ku disa biznese mund të përmbushin praktikën më të mira ndërkombëtare ndërsa të tjera jo. Ky skenar do të çonte në një treg të fragmentuar ku shoqëritë që respektojnë standardet ndërkombëtare do të ishin në një pozitë disavantazhi krahasuar me ato që shmangin detyrimet rregullore. Kjo gjithashtu do të dobësonte aftësinë e shtetit për të monitoruar dhe zbatuar përputhshmërinë ligjore në mënyrë efektive, duke çuar në mundësi të abuzimit dhe praktika të padrejta.
5. Qëllimi i strategjisë së integritit të Shqipërisë në BE është harmonizimi i standardeve të saj me ato evropiane për të fituar akses në përfitimet e anëtarësisë, si rritja ekonomike, stabiliteti politik dhe integriteti në treg. Një qasje jo rregullore do të shkelte këtë strategji dhe do të funksiononte kundër objektivave për miratimin e ligjeve dhe përputhjes me BE-në.

Për këto arsye, opsioni jo rregullator nuk mund të konsiderohet si një mundësi e vlefshme për harmonizimin e ligjit të shoqërive të Shqipërisë me rregulloret e BE-së. Vendi duhet të zbatojë masa rregullore të plota për të përmbushur angazhimet e tij për integritetin në BE, për të promovuar besueshmërinë e investitorëve, për të siguruar kushte të drejta konkurruese dhe për të mbrojtur të drejtat e palëve të interesuara në një mënyrë që është në përputhje me standardet evropiane.

## **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

*h) Identifikoni grupet e prekura.*

*i) Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

*j) Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- b. Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- c. Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
- d. Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*

*k) Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*

- a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- b. Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

*l) Diskutoni kufizimin e analizës:*

- a. Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- b. Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

*m) Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- a. Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- b. Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- c. *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Identifikimi i grupeve të prekura:

1. Bizneset, veçanërisht ato të mëdha dhe të huaja
2. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs)
3. Institucionet shtetërore
4. Shoqëria civile dhe sektori i mbikëqyrjes
5. Investitorët e huaj dhe ata vendas
6. Profesionalët ligjorë
7. Aksionarët/ortakët (përfshirë aksionarët e pakicës)
8. Noterët

Ndryshimet ligjore do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në këto grupe. Ndërmarrjet dhe sektorët që operojnë në tregje ndërkombëtare, si dhe institucionet që mbikëqyrin këto aktivitete, do të përballen me sfida dhe mundësi për shkak të kërkesave të reja për transparencë, qeverisje korporative dhe operacione ndërkufitare.

Identifikimi i llojeve të ndikimeve për secilin grup të prekur:

Zbatimi i rregulloreve të reja do të ketë një ndikim të rëndësishëm mbi grupet e ndryshme të prekura, duke krijuar mundësi për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe rritjen e mundësive për investitorët dhe shoqëri në Shqipëri.

Për bizneset, zbatimi i ligjeve të reja do të krijojë një mjedis më të qartë dhe të parashikueshëm, duke rritur besimin dhe duke krijuar mundësi më të mira për të bërë biznes, sidomos për shoqëritë ndërkombëtare që kërkojnë një kuadër ligjor të besueshëm për operacionet ndërkufitare. Përshtatja e legjislacionit do të ndihmojë në tërheqjen e investitorëve të rinj dhe do të hapë mundësi të reja për bizneset lokale, sidomos në sektorët e teknologjisë dhe industrisë, duke rritur konkurrencën dhe duke krijuar një mjedis të favorshëm për rritjen e diversifikimit ekonomik.

Institucionet shtetërore, përfshirë QKB-në, MEKI etj, do të përballen me nevojën për të përmirësuar kapacitetet e tyre për të monitoruar dhe zbatuar ligjet e reja. Përshtatja me rregulloret e BE-së do të kërkojë burime shtesë, trajnime dhe mbështetje teknike, por kjo do të ndihmojë në krijimin e një sistemi më të fortë dhe më efikas të mbikëqyrjes dhe monitorimit të tregut të biznesit. Përshtatja e këtyre institucioneve do të kontribuoni në një mbikëqyrje më të besueshme dhe në përputhshmëri të ligjshme me standardet e BE-së.

Për aksionarët, zbatimi i këtyre rregulloreve do të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe do të sigurojë një mjedis ligjor më të sigurt dhe më të qartë. Kjo do të rrisë besimin e investitorëve, duke u siguruar atyre mundësi për të ushtruar të drejtat e tyre në mënyrë të transparencës dhe të rregulluar, duke kontribuar në stabilitetin e tregut dhe duke rritur besimin në strukturat korporative.

Këto ndryshime nuk do të prekin vetëm kuadrin ligjor dhe rregullator, por do të luajnë gjithashtu një rol kyç në përmirësimin e mjedisit të biznesit në Shqipëri, rritjen e tërheqjes për investimet e huaja dhe përsheptimin e integritetit të Shqipërisë në BE. Kjo pjesë do të vlerësojë ndikimet ekonomike, sociale dhe

institucionale të pritura, duke marrë parasysh si efektet afatshkurtra ashtu edhe ato afatgjata, si dhe kostot dhe përfitimet e mundshme që lidhen me secilin opsion të politikës.

### Ndikimi ekonomik

Hyrja në fuqi e ligjit të ri do të forcojë klimën e investimeve dhe rritë konkurrencën në ekonomi. Nga ana e kërkesës, bizneset shqiptare do të kenë mundësi më të mira për të pasur pjesëmarrje aktive në projekte ndërkufitare dhe shtrirje rajonale, duke minimizuar kostot shtesë procedurale. Kjo do të rrisë tërheqjen e kapitalit të huaj, veçanërisht në sektorë si teknologjia dhe shërbimet, duke krijuar një ambjent më të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për investitorët. Nga ana e ofertës, ekonomia do të përfitojë nga përmirësimi i efikasitetit në treg; lehtësimi i hyrjes dhe daljes së kapitalit nga Shqipëria nënkupton rritje të operacioneve të biznesit dhe hapje të tregjeve të reja. Sfidat fillestare ekonomike (p.sh. volumin fillestar të bizneseve që hyjnë në proceset ndërkufitare) priten të jenë të vogla, ndërsa përfitimet afatgjata – në formën e rritjes së produktivitetit dhe shtimit të investimeve – i tejkalojnë të gjithë kostot..

**Rritja e Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta (FDI):** Harmonizimi me Direktivën do të rrisë tërheqjen e Shqipërisë si destinacion investimi. Krijimi i një mjedisi ligjor më të parashikueshëm dhe transparent do të tërheqë më shumë FDI, veçanërisht në sektorë si teknologjia, prodhimi dhe shërbimet, ku investitorët ndërkombëtarë kërkojnë qartësi për të drejtat e aksionarëve, qeverisjen korporative dhe mundësinë për të realizuar transaksione ndërkufitare.

**Përmirësimi i qasjes në tregjet e BE-së:** Integrimi i Shqipërisë në tregun e brendshëm të BE-së do të forcohet duke lejuar që bizneset shqiptare të operojnë në disa juridiksione me më pak pengesa ligjore. Kjo do të përmirësojë konkurrencën dhe do të lehtësojë qasjen në tregje më të mëdha.

dhe inovacionin, duke kontribuar në diversifikimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës.

Komisioni Evropian ka parashikuar se zbatimi i Direktivës (BE) 2019/2121”, do të sjellë kursime për ndërmarrjet në një vlerë që varion nga 176 milionë deri në 280 milionë euro në të gjithë Bashkimin Evropian. Këto përfitime priten si rezultat i harmonizimit të procedurave për transformimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare, të cilat synojnë të reduktojnë pasiguritë ligjore dhe barrën administrative për bizneset që operojnë në më shumë se një shtet anëtar të BE-së. (Burimi: Komisioni Evropian – europa.eu)

Për një vend si Shqipëria, një përfitim prej 30 deri në 40 milionë euro është i arsyeshëm nisur nga fakti që transpozimi i Direktivës (BE) 2019/2121 krijon një kuadër të harmonizuar ligjor për transformimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare, duke ulur ndjeshëm pasiguritë ligjore dhe barrën administrative për bizneset, si dhe duke nxitur mobilitetin ndërkufitar dhe tërheqjen e investimeve. Për më tepër, Shqipëria është në procesin e përafrimit me acquis të BE-së dhe synon të rrisë ndjeshëm qarkullimin ndërkufitar të kapitalit dhe bizneseve në kuadër të integritimit evropian, çka e bën përfitimin potencial edhe më të lartë nëse reformat shoqëruese zbatohen me sukses.

**Kostot e mundshme ekonomike:** Kostot e menjëhershme që lidhen me harmonizimin përfshijnë kostot e rishikimit të ligjit, përditësimin e proceseve institucionale, trajnimin e profesionistëve dhe implementimin e sistemeve të reja për monitorimin e përputhshmërisë. Mund të ketë disa përshtatje afatshkurtra pasi bizneset me rregullat dhe kërkesat e reja të përputhshmërisë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME). Megjithatë, këto janë të përkohshme dhe përfitimet afatgjata do të tejkalojnë kostot e përshtatjes.

## Ndikimi social

Ndikimi social i harmonizimit të ligjit me *acquis-in* e BE-së është gjithashtu i rëndësishëm. Harmonizimi me rregulloret e BE-së jo vetëm që përmirëson mjedisin ligjor për bizneset, por do të hapë rrugë që në të ardhmen për shembull traspozimit të Direktives 2022/2381, e cila kërkon balancën gjinore mes drejtorëve të shoqërive të listuara, për promovimin e barazisë gjinore në sektorin korporativ të Shqipërisë.

Po ashtu, forcimi i të drejtave të aksionarëve, veçanërisht për aksionarët e pakicës, është në përputhje me objektivat më të gjerë të BE-së për të promovuar transparencën dhe përgjegjësinë më të madhe në praktikat e biznesit.

Kalimi në një kuadër ligjor më të harmonizuar me BE-në mund të kërkojë nga disa biznese që të ristrukturohen. Megjithatë, këto kosto priten të tejkalohen nga përfitimet afatgjata. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri mund të përballen me sfida në përshtatjen me kuadrin ligjor të ri. Këto biznese mund të kenë nevojë për mbështetje dhe trajnime shtesë për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e reja. Kjo mund të zbutet përmes ndihmës teknike dhe programeve trajnimit nga qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë.

## Ndikimi institucional

Zbatimi i projektligjit për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare do të ketë një ndikim të rëndësishëm institucional, duke përfshirë konsolidimin e kapaciteteve të disa institucioneve kyçe që marrin pjesë në zbatimin e legjislacionit të shoqërive tregtare dhe operacioneve ndërkufitare. Konkretisht, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës, si dhe potencialisht Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nëse përfshihen ndërmarrje të listuara apo grupe financiare në operacione ndërkufitare, do të jenë përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe interpretimin e dispozitave të reja që burojnë nga transpozimi i Direktivës (BE) 2019/2121.

Për zbatimin efektiv të dispozitave të projektligjit, këto institucione do të duhet të forcojnë kapacitetet teknike dhe njerëzore për përpunimin e kërkesave ndërkufitare, dhënien e certifikatave dhe ndërlidhjen me sistemin e ndërlidhur të regjistrave të BE-së (BRIS), duke siguruar që procedurat të përputhen me standardet e zbatueshme evropiane për transparencë, qartësi dhe akses publik.

Ky zhvillim institucional pritet të përmirësojë parashikueshmërinë e kuadrit ligjor dhe administrativ, të lehtësojë procedurat për bizneset dhe të rrisë besimin në sistemin e regjistrimit dhe kontrollit të operacioneve ndërkufitare. Koordinimi ndër-institucional do të thellohet përmes mekanizmave të integruar të ndarjes së të dhënave, shkëmbimit të njoftimeve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me sistemet e regjistrimit të vendeve anëtare të BE-së.

Në këtë kuadër, projektligji krijon bazën për ngritjen e praktikave të unifikuara me standardet e BE-së për të drejtat e kreditorëve, aksionarëve dhe punonjësve gjatë procesit të shndërrimeve, bashkimeve apo ndarjeve ndërkufitare, duke imponuar detyrime të reja për vlerësim të ndikimit, transparencë dhe certifikim nga autoritete të përcaktuara si noterët apo ekspertët e pavarur.

a. Përshkrimi cilësor i ndikimeve të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura:

Bizneset, veçanërisht ato që synojnë zgjerim në tregje të BE-së ose kanë struktura të përbashkëta me shoqëri të huaja, do të përfitojnë nga një sistem më i qartë dhe i harmonizuar për operacionet ndërkufitare, i cili garanton trajtim të barabartë dhe eliminon pengesat ligjore për transformim dhe ristrukturim. Rregullat për njoftimin dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicës, transparencën e çmimeve të transferimit, dhe raportimin financiar, do të ndihmojnë në uljen e asimetrisë së informacionit dhe në rritjen e efikasitetit të tregut.

Noterët do të kenë një rol të zgjeruar në verifikimin formal të dokumentacionit dhe pajtueshmërisë ligjore të procedurave ndërkufitare, duke kryer certifikime për pajtueshmëri dhe raportime sipas modelit të përcaktuar nga Direktiva. Kjo rrit kërkesat për kualifikime shpesh dhe përditësim të praktikave ekzistuese.

b. Analiza nga ana sasiore e ndikimeve të drejtpërdrejta:

Bazuar në të dhënat e INSTAT për vitin 2023, në Shqipëri janë të regjistruara mbi 150,000 shoqëri, shumica prej të cilave përfaqësojnë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (SMEs). Rreth 5.3% e tyre janë shoqëri me kapital të huaj ose ndërkombëtar dhe rreth 3% kanë kryer operacione transformimi të brendshëm që mund të përkthehen në operacione ndërkufitare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Me zbatimin e ligjit, numri i operacioneve ndërkufitare të lehtësuara pritet të rritet me rreth 15–25% në vitin e parë, duke reflektuar interesin e shtuar të tregut për struktura të thjeshtuara dhe procedura të njohura ndërkombëtarisht.

c. Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur:

Bazuar në një vlerësim konservator të rritjes së Investimeve të Huaja Direkte (FDI) në masën 2% të PBB-së si rezultat i përmirësimit të mjedisit ligjor dhe institucional, dhe duke marrë për bazë PBB-në prej 23.6 miliardë euro për vitin 2023 (INSTAT), përfitimi ekonomik vjetor i pritshëm varion nga 47 milionë deri në 50 milionë euro.

Kjo shifër përfshin rritjen e kapitalit, zgjerimin e operacioneve dhe punësimin, si dhe zvogëlimin e rrezikut ligjor dhe të kostove të paqarta transaksionale që aktualisht pengojnë aktivitetet ndërkufitare. Kjo shumë tejkalon disa herë investimet fillestare në trajnime dhe azhurnim teknologjik nga institucionet publike, të cilat përlllogariten në më pak se 2 milionë euro për tre vitet e para.

d. Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka):

SMEs do të preken në dy mënyra:

Pozitivisht, pasi procedurat e standardizuara për bashkime dhe ndarje do të ulin kostot ligjore dhe kohën e përpunimit të transaksioneve, duke rritur aksesin në partneritete dhe financime ndërkufitare;

Negativisht, nëse nuk marrin mbështetje teknike dhe informim adekuat për të zbatuar ndryshimet, mund të hasin vështirësi në përshtatjen me rregullat e reja. Kjo është veçanërisht e vërtetë për subjektet që operojnë në bashkëpronësi ose në sektorë të rregulluar si farmaceutika, telekomunikacioni apo ndërtimi.

Për këtë arsye, programet e ndërgjegjësimit dhe asistencës teknike të drejtuara nga QKB, Dhomat e Tregtisë, agjencitë e zhvillimit rajonal dhe organizatat e sipërmarrjes, janë thelbësore për të minimizuar këtë ndikim negativ dhe për të garantuar akses të barabartë në përfitimet e ligjit të ri..

Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

a. Përshkrimi nga ana cilësore i ndikimeve jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura:

Për Shqipërinë, implementimi i këtyre ndryshimeve do të përmirësojë imazhin e vendit si një destinacion investimi tërheqës, duke kontribuar në një ambient më të hapur dhe konkurrues për bizneset. Ky ndikim i drejtpërdrejtë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e investimeve të huaja dhe në konsolidimin e tregjeve të brendshme. Përafrimi i kuadrit ligjor me direktivën e kodifikuar 2017/1132 të BE-së do të forcojë reputacionin e Shqipërisë si një vend që ofron kushte të parashikueshme, transparente dhe të krahasueshme me vendet anëtare të BE-së përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve, sigurisë së transaksioneve ndërkufitare dhe efikasitetit të procedurave të ristrukturimit.

b. Analizoni ndikimin mbi konkurrencën:

Projektligji do të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e konkurrencës në tregun vendas përmes dy mekanizmave parësorë:

- Lehtësimi i aksesit të bizneseve shqiptare në tregun e brendshëm të BE-së përmes operacioneve të ristrukturimit ndërkufitar që respektojnë standardet e përbashkëta për transparencën, publikimin dhe mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve dhe kreditorëve.
- Rritja e presionit konkurrues në tregun vendas, për shkak të hyrjes më të lehtë të entiteteve të huaja përmes shndërrimeve apo bashkimeve ndërkufitare të thjeshtuara, çka do të nxisë bizneset shqiptare të përmirësojnë cilësinë, transparencën dhe strukturën e tyre organizative.

Për më tepër, standardizimi i procedurave do të eliminojë avantazhet e padrejta që mund të kenë shoqëri që operojnë me praktika jo të përputhura me normat e BE-së, duke krijuar një “fushë loje të barabartë” për të gjithë operatorët..

#### Diskutimi i kufizimit të analizës:

a. Supozimet dhe risqet:

Analiza mbështetet në disa supozime themelore:

- Që institucionet përgjegjëse (MEKI, QKB, noterët, gjykatat) do të kenë kapacitetin teknik dhe burimet e nevojshme për zbatimin e ligjit brenda afateve të përcaktuara.
- Që përfitimet e ligjit do të manifestohen me shpejtësi në terma të rritjes së FDI-së dhe të transaksioneve ndërkufitare.
- Që do të sigurohet ndërgjegjësimi dhe trajnimi adekuat i grupeve të interesit, veçanërisht i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Risqet më të mëdha lidhen me:

- vonesa në ngritjen e sistemeve të ndërveprueshme digjitale me regjistrat e huaj (BRIS);
- mungesë përgatitjeje të mjaftueshme të noterëve dhe autoriteteve për të lëshuar certifikata të përputhshmërisë sipas kërkesave të BE-së;

Rezistencë e mundshme mund të ketë nga pjesë të sektorit privat për shkak të kompleksitetit apo kostove fillestare të përshtatjes.

**b. Pengesat që mund të ndikojnë në realizimin e përfitimeve:**

Përfitimet që lidhen me krijimin e një mjedisi më të thjeshtë për SME mund të përkthehen në rritjen e numrit të biznesve të regjistruara dhe operacioneve të reja, duke ndikuar pozitivisht në punësimin dhe rritjen e produktivitetit. Pengesat mund të përfshijnë vonesat në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe implementimin e mjetëve digjitale, të cilat do të kërkojnë burime të konsiderueshme financiare. Gjithashtu, ka mundësi që SMEs të përballen me vështirësi për t'u përshtatur me këto ndryshime për shkak të kostos dhe nevojës për trajnime të mëtejshme.

Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

a. Pasqyrë përmbledhëse e të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara:

Ndikimet e analizës përfshijnë krijimin e një mjedisi të përmirësuar ligjor për bizneset dhe rritjen e mundësive për operacione ndërkufitare, që do të mundësojnë një integrim më të thellë të Shqipërisë në tregun e BE-së. Përshtatja me standardet e BE-së, duke përfshirë bashkimet ndërkufitare, shndërrimet dhe ndarjet, do të rrisë transparencën dhe do të përmirësojë mbrojtjen e aksionarëve, sidomos të aksionarëve të pakicës. Përmirësimi i qeverisjes korporative do të kontribuoni në zhvillimin e një tregu më konkurrues dhe më të besueshëm. Përmes përputhshmërisë me direktivat e BE-së, Shqipëria do të krijojë një mjedis të favorshëm për investitorët ndërkombëtarë dhe për zhvillimin e sektorëve ekonomikë, përfshirë shërbimet, teknologjinë dhe prodhimin.

b. Krahasimi i ndikimeve të të gjitha opsioneve të analizuara:

Opsioni 0 – Status quo, është i papranueshëm në kushtet aktuale, pasi do të ruante boshllëqet ekzistuese dhe do të pamundësonte përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë sipas MSA-së dhe procesit të negociatave për Kapitullin 6. Do të përjashtonte Shqipërinë nga përfitimet e integritit të plotë ligjor dhe ekonomik me BE-në.

Opsioni 1 – hartimi i një ligji të ri (opsioni i preferuar): Përfaqëson një zgjidhje të balancuar, efektive dhe të përballueshme për Shqipërinë. Duke ruajtur strukturën ekzistuese të ligjeve ky opsion mundëson harmonizimin e shpejtë me direktivat e BE-së, minimizon koston institucionale dhe promovon siguri juridike dhe besueshmëri për investitorët. Opsioni është gjithashtu më i zbatueshëm nga institucionet dhe më lehtësisht i përthithshëm nga grupet e interesit.

Opsioni 2 – ndryshimi i ligjit ekzistues. Edhe pse teorikisht do të siguronte një përputhje gjithashtu të plotë, është një opsion që nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe hartimit të legjislacionit është jo e pranueshme për shkak të kompleksitetit dhe madhësisë së ndërhyrjeve të parashikuara që janë praktikisht një ligj më vete.

Opsioni 3 – Qasje jo rregullatore, është i papajtueshëm me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, minon zbatimin e acquis-it, dhe do të linte vendin pa instrumente të detyrueshme për të siguruar mbrojtjen e aksionarëve, transparencën dhe funksionimin e drejtë të tregut. Për rrjedhojë, ky opsion përjashtohet plotësisht.

c. Përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion:

Përfitimet monetare nga implementimi i këtyre ndryshimeve ligjore mund të përkthehen në rritje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta, që mund të arrijnë disa milionë euro gjatë periudhës së parë pas implementimit të reformave. Ky investim do të kontribuoni në zhvillimin e sektorëve të shërbimeve, teknologjisë dhe prodhimit, duke sjellë rritje të mundshme të PBB-së dhe duke krijuar mundësi të reja për



krijimin e vendeve të punës. Për më tepër, duke siguruar përputhshmëri të plotë me rregulloret e BE-së dhe duke përmirësuar konkurrencën, Shqipëria mund të rrisë pozicionin e saj si destinacion investimesh dhe të mundësojë operacione më të lehta dhe më të shpejta ndërkufitare. Bazuar në përlllogaritjet aktuale dhe projeksionet e Bankës Botërore, rritja e investimeve të huaja direkte si rezultat i harmonizimit me acquis-in e BE-së mund të çojë në një kontribut prej 2% deri në 5% të PBB-së gjatë 3–5 viteve të para pas miratimit të projektligjit. Duke marrë për bazë PBB-në e Shqipërisë për vitin 2023 (~23.6 miliardë euro), kjo përkthehet në një përfitim potencial nga 47.2 milionë deri në 118 milionë euro, duke mbuluar kostot fillestare të zbatimit dhe duke prodhuar përfitime të konsiderueshme neto.

### **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

### **Opsioni i preferuar është Opsioni 1- Ndryshime në legjislacionin ekzistues.**

Ky opsion përfaqëson një ndërhyrje të qartë, të synuar dhe të përqendruar ekskluzivisht në transpozimin e plotë të dispozitave që përfshijnë shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare janë të rregulluara nga Titulli II i Direktivës (BE) 2017/1132, e cila është ndryshuar ndjeshëm nga Direktiva (BE) 2019/2121, me qëllim që të forcojë lirinë e vendosjes së shoqërive brenda Bashkimit Evropian dhe të sigurojë një kuadër të harmonizuar ligjor për këto operacione ndërkufitare. Konkretisht:

Bashkimet ndërkufitare janë të rregulluara në Kapitullin II të Titullit II, në nenet 118 deri 122, dhe ofrojnë dispozita të detajuara për procedurën e bashkimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar që janë të regjistruara në shtete të ndryshme anëtare. Ky kapitull ka origjinën nga Direktivës 2005/56/KE dhe është inkorporuar në mënyrë të kodifikuar në Direktivën 2017/1132.

Shndërrimet ndërkufitare janë për herë të parë të rregulluara në nivel të BE-së përmes Kapitullit III, që përfshin nenet 86a deri 86k. Këto dispozita janë shtuar nga Direktiva (BE) 2019/2121 dhe lejojnë një shoqëri që është e regjistruar në një shtet anëtar të BE-së të transformohet në një shoqëri të një forme ekuivalente në një shtet tjetër anëtar, pa humbur personalitetin juridik.

Ndarjet ndërkufitare janë trajtuar në Kapitullin IV, në nenet 160a deri 160l, po ashtu të futur përmes Direktives 2019/2121. Ky kapitull parashikon një kuadër të harmonizuar për ndarjet ndërkufitare, duke përfshirë ndarjet tërësore, pjesore dhe me ndarje të pjesshme aktive. Ai synon të mbrojë në mënyrë të ekuilibruar interesat e kreditorëve, aksionarëve dhe punonjësve.

Duke qenë se Ligji nr. 9901/2008 dhe Ligji nr. 110/2012 nuk përmbajnë strukturë të mjaftueshme për të trajtuar këto institute në përputhje me kërkesat e direktivës, dhe duke marrë parasysh ndryshimet substanciale në të drejtën evropiane pas vitit 2021, u vlerësua se krijimi i një ligji të ri të posaçëm është rruga më efikase dhe më pak intruzive për sistemin ekzistues të së drejtës së shoqërive.

Ky opsion siguron transpozim të qartë, të aksesueshëm dhe të matshëm të dispozitave të direktivës, duke ndarë legjislacionin ndërkufitar nga ai i brendshëm. Ai parashikon standarde minimale për raportet e shoqërisë, mbrojtjen e kreditorëve dhe të punonjësve, të drejtat e anëtarëve që kundërshtojnë transformimin, si dhe rregullat për publikimin, certifikimin dhe ndërlidhjen e informacionit ndërkufitar përmes sistemit BRIS, në përputhje me Rregulloren e Zbatimit (BE) 2021/1042.

Ky opsion është zgjedhur për arsye të mëposhtme:

**Përqendrim funksional dhe saktësi legjislative:** Projektligji i ri ofron një strukturë të dedikuar për operacionet ndërkufitare, duke reduktuar mbivendosjet me ligjin tregtar në fuqi dhe duke lejuar ndërtimin e një mekanizmi të specializuar transpozimi për secilin nga tre institucionet juridike (shndërrimi, bashkimi, ndarja).

**Koherencë me strukturën e Direktivës 2019/2121:** Krijimi i një ligji të veçantë lejon ruajtjen e rendit logjik të dispozitave të BE-së, duke shmangur ndërthurje të tepërta në tekstet ekzistuese dhe duke mundësuar përputhshmëri të plotë me nen për nen të direktivës.

**Lehtësim institucional dhe trajnueshmëri më e madhe:** Për shkak se institucione si QKB, MEKI dhe noterët nuk kanë pasur më parë eksperiencë në administrimin e ndarjeve dhe shndërrimeve ndërkufitare, krijimi i një ligji të veçantë me procedura të qarta i ndihmon ata të zbatojnë më shpejt dhe më saktë ndryshimet. Për më tepër, kjo u mundëson autoriteteve shqiptare të përfshijnë përmbajtjen e plotë të pjesëve përkatëse të Manualeve të Komisionit Evropian për aplikimin e direktivës (p.sh. BRIS Implementation Manual dhe EU Company Law Toolbox), pa e ngarkuar ligjin ekzistues.

**Zbatim më i parashikueshëm për subjektet tregtare dhe profesionistët ligjorë:** Duke ruajtur paprekur strukturën e ligjeve bazë si Ligji nr. 9901/2008, Ligji nr. 9723/2007, ky opsion minimizon ngarkesën e adaptimit për bizneset dhe praktikat ligjore që operojnë me sistemin ekzistues. Kjo shmang konfuzionin nga ndryshime të shumta paralele dhe ruan stabilitetin e kuadrit për transaksione të brendshme.

**Mbështetje për implementimin digjital dhe ndërlidhjen me BRIS:** Projektligji parashikon përdorimin e identifikuesve unikë, certifikatave elektronike dhe publikut ndërkufitar përmes platformës evropiane, duke përmbushur kërkesat e nenit 16 dhe 130 të Direktivës 2017/1132 dhe rregulloren zbatuese për BRIS-in.

#### Kostot Buxhetore

Kostot buxhetore të implementimit të Opsionit 1 janë disa, por të menaxhueshme në kuadrin e strategjisë më të gjerë të integritimit të Shqipërisë në BE. Investimet e nevojshme do të drejtohen kryesisht në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë programe trajnimi për profesionistët, krijimin e infrastrukturës digjitale dhe për operacionet ndërkufitare. Gjithashtu, financimi do të jetë i nevojshëm për konsultime, këshilla nga ekspertë dhe kostot administrative të miratimit dhe zbatimit të ligjeve të reja.

Duke qenë se e kemi të pamundur të kryejmë një analizë sasiore të ndikimeve ekonomike të opsionit të preferuar, pasi kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në vlerë monetare rezulton i pjesshëm dhe i vështirë për t'u bërë, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet metodën e analizës me shumë kriterë.

Si rezultat kemi identifikuar 5 kriterë me rëndësi për të vlerësuar:

- Përmirësimi, harmonizimi dhe qartësimi i kuadrit ligjor lidhur me shoqëritë tregtare mbi bazën e ligjeve ekzistuese - 4
- Përfshirja e bashkimit, ndarjes ndërkufitare, mbrojtjes aksionare etj në ligje tashmë të njohura – 3;
- Krijimi i mekanizmave për përafrim digjital; - 4
- Efikasiteti në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimi me efencë i kuadrit ligjor.-3
- Kosto më të njohura administrative; - 3

Këto kriterë janë vlerësuar me pikë për secilin opsion si vijon:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Përmirësimi, harmonizimi dhe qartësimi i kuadrit ligjor lidhur me shoqëritë	4	0 (0)	3 (12)	0 (0)

tregtare mbi bazën e ligjeve ekzistuese				
Përfshirja e bashkimit, ndarjes ndërkufitare, mbrojtjes aksionare etj në ligje tashmë të njohura	3	0 (0)	3 (9)	2(6)
Krijimi i mekanizmave për përafrim digjital	4	0 (0)	4 (16)	0(0)
Efikasiteti në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimi me efencë i kuadrit ligjor.	3	2 (6)	3 (9)	2 (6)
Kosto më të njohura administrative;	3	0 (0)	2 (6)	0 (0)
<b>Pikët</b>		<b>6</b>	<b>52</b>	<b>12</b>

Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret e përmendura si më lart, duke vlerësuar secilin opsion, rezulton se opsioni 1 ka numrin më të lartë të pikëve me 52 krahasuar me opsionet e tjera.

### **Çështje të zbatimit**

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

### Struktura përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur

**Ministria përgjegjëse për ekonominë.** Si institucioni kryesor që mbikëqyr politikën ekonomike dhe reformën rregullatore, ministria përgjegjëse për ekonominë do të luajë një rol kyç në sigurimin e miratimit dhe integritet të ndryshimeve ligjore në kuadrin ligjor kombëtar. Ajo do të mbikëqyr harmonizimin me direktivat e BE-së dhe do të punojë me institucione të tjera për të zhvilluar strategjitë e implementimit.

**Ministria përgjegjëse për financat** nga ana tjetër do të jetë gjithashtu përgjegjëse për lidhjen me BE-në dhe monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat fiskale dhe ligjore të BE-së, çka do të fusë në lojë edhe administratën tatimore.

**Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB):** QKB do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të bizneseve dhe implementimin e mjeteve digjitale për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e reja dhe standardet për operacionet ndërkufitare. Ajo do të punojë me ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe institucione të tjera, të tilla si AKSHI dhe AKCESK për të siguruar që procedurat e regjistrimit të bizneseve dhe rregulloret të jenë të thjeshtuara dhe në përputhje me kërkesat e BE-së. QKB do të luajë një rol kyç në digjitalizimin e regjistrave dhe përdorimin e platformave digjitale për të lehtësuar regjistrimin dhe proceset e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Pasi specifikimet teknike të regjistrave të biznesit që do të lidhën midis tyre, të rishikohen nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, mund të vazhdohet me hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren për të mundësuar lidhjen e regjistrimit të biznesit të Shqipërisë me BRIS.

**Instituti i Statistikave (INSTAT):** INSTAT do të mbledhë dhe analizojë të dhëna për të matur ndikimin e reformave. Ajo do të ndjekë tregues ekonomikë si rritja e biznesit, investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe

standardet e qeverisjes korporative. INSTAT do të ofrojë të dhëna që do të udhëheqin rregullimet dhe përmirësimet e ardhshme në kuadrin rregullator.

**Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:** Kjo ministri do të përqendrohet në mbështetje të bizneseve, veçanërisht SME-ve, për t'u përshtatur me kërkesat e reja ligjore. Ajo do të ofrojë trajnim, asistencë financiare dhe shërbime këshillimore për të ndihmuar bizneset të përmbushin ligjin e përditësuar të shoqërive. Ministria gjithashtu do të monitorojë ndikimin social të reformave, veçanërisht për ndërmarrjet më të vogla.

**Autoriteti i Konkurrencës:** Shoqëritë të sigurojnë përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës kur ato përmbushin kriteret e përcaktuara për bashkimet ndërkufitare, për të shmangur pasojat ligjore dhe financiare që mund të lindin nga mosnjoftimi. Harmonizimi i legjislacionit të Shqipërisë do të rrisë konkurrencën në tregun lokal, duke mundësuar që bizneset shqiptare të konkurrojnë në kushte të barabarta me ato të vendeve të BE-së. Për më tepër, krijimi i një tregu të hapur dhe të parashikueshëm për investitorët do të ndihmojë në diversifikimin e ekonomisë dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Autoriteti i Konkurrencës do të duhet të jetë më i vëmendshëm për përqendrimet e reja që mund të krijohen në treg apo mbrojtjen e konkurrencës së pandershme në përgjithësi

**Noterët:** Direktiva 2005/56/KE, e cila trajtonte bashkimet ndërkufitare, është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga Direktiva 2017/1132 (direktiva e kodifikuar), veçanërisht nga dispozitat që lidhen me shndërrimet ndërkufitare, bashkimet dhe ndarjet. Ndryshimet kyçe që ndikojnë tek noterët në kontekstin e Direktives 2017/1132 lidhen me thjeshtimin e procedurave dhe futjen e rregullave më të qarta për implementimin e operacioneve ndërkufitare, duke përfshirë bashkimet dhe ndarjet. Ndikimi rregullator për noterët është kryesisht lidhur me këto përshtatje procedurale, duke siguruar përputhshmërinë me kuadrin e ri ligjor të BE-së dhe duke kontribuar në një proces më të thjeshtë dhe efikas për shoqëritë që angazhohen në operacione ndërkufitare brenda BE-së.

#### Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Për zbatimin e plotë të opsionit të zgjedhur mund të ketë disa pengesa të mundshme. Një pengesë mund të jetë mungesa e kapaciteteve institucionale për të përballuar ngarkesën e shtuar që lidhet me zbatimin e ligjeve të reja. Përshtatja e institucioneve shtetërore dhe forcimi i kapaciteteve për të monitoruar dhe implementuar ligjet kërkon investime në trajnim dhe infrastrukturë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të kenë vështirësi për t'u përshtatur me kërkesat e reja ligjore dhe mund të kërkojnë mbështetje shtesë për të siguruar përputhshmërinë. Për më tepër, mungesa e burimeve për të mbështetur ndryshimet në infrastrukturën digjitale dhe proceset administrative mund të ngadalësojë implementimin. Një pengesë tjetër mund të jetë mungesa e transparencës dhe komunikimit të qartë me bizneset për rregullat dhe procedurat e reja.

#### Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës

Për të siguruar qëllimet e politikës dhe për të mundësuar zbatimin e suksesshëm të opsionit të zgjedhur, do të ndërmerren disa masa kyçe. Këto përfshijnë:

- Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit e institucioneve shtetërore, për t'u njohur me kërkesat e reja ligjore dhe për të siguruar implementimin e duhur të ndryshimeve. Pjesëmarrja në trajnime ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me ekspertë do të rrisin aftësitë e këtyre institucioneve.
- Ofrimi i mbështetjes teknike dhe financiare për bizneset për t'i ndihmuar të përmbushin kërkesat e reja ligjore. Kjo mund të përfshijë mundësi për trajnime, udhëzime dhe asistencë për të përmbushur rregullat e reja të regjistrimit dhe të qeverisjes korporative. Po ashtu, mund të krijohen lehtësira për SME për të reduktuar ngarkesat administrative gjatë fazës së kalimit në legjislacionin e ri.
- Sigurimi i investimeve të nevojshme për përmirësimin e sistemeve digjitale dhe të platformave për regjistrimin e bizneseve, për të mundësuar një kalim të lehtë dhe të shpejtë nga sistemi aktual në një sistem të harmonizuar me systemin BRIS të BE-së. Ky përmirësim do të mundësojë edhe një

shkëmbim të shpejtë dhe të sigurt të të dhënave ndërmjet institucioneve shtetërore dhe regjistrave të biznesit.

- Përdorimi i mekanizmave të përhershëm për të monitoruar implementimin dhe për të vlerësuar ndikimet e reformës. Ky mekanizëm do të ndihmojë për të siguruar që ligjet të zbatohet siç duhet dhe që të gjithë aktorët e përfshirë të marrin mbështetje të nevojshme për të përmbushur kërkesat e reja.
- Përdorimi i platformave të komunikimit për të informuar dhe ndihmuar bizneset dhe investitorët për rregullat dhe ndryshimet e reja ligjore. Kjo do të ndihmojë në lehtësimin e kalimit dhe do të sigurojë që të gjitha palët të kenë informacion të qartë dhe të azhurnuar për ndryshimet ligjore dhe procedurat e reja.

#### **Faza e monitorimit dhe vlerësimit**

4. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
5. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Në përputhje me raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024, Shqipëria inkurajohet të përmirësojë kapacitetet e saj institucionale për monitorimin dhe zbatimin e reformave në ligjin e shoqërive. Raporti thekson se përparimi aktual në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së, veçanërisht ato që lidhen me bashkimet ndërkufitare, ndarjet dhe shndërrimet, ka qenë i ngadaltë, me disa boshllëqe në transpozim dhe zbatim. Qeverisë shqiptare i sugjerohet forcimi i mekanizmave për monitorimin e implementimit të ndryshimeve ligjore dhe sigurinë që ato të zbatohen në mënyrë efektive. Në këtë kontekst, Shqipëria duhet të fokusohet në përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve kyçe. Për të adresuar këto boshllëqe, Shqipëria do të duhet të investojë në ndërtimin e kapaciteteve për këto institucione, duke siguruar që ato të kenë ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive kuadrin ligjor të përditësuar. Gjithashtu, është thelbësore të krijohen sisteme të qarta monitorimi dhe vlerësimi për të ndjekur përparimin e reformave dhe për të vlerësuar ndikimin e tyre, duke siguruar që Shqipëria të përmbushë detyrimet e saj ndaj BE-së dhe të mundësojë një integrim më të lehtë në tregun e brendshëm të BE-së. Këto hapa do ta ndihmojnë Shqipërinë të arrijë përputhshmërinë e plotë me standardet e BE-së në ligjin e shoqërive dhe të përmirësojë mjedisin e biznesit, duke nxitur rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

#### Përshkrimi i masave të monitorimit dhe të vlerësimit:

Për të siguruar që zbatimi i ligjeve të reja dhe harmonizimi i legjislacionit të Shqipërisë me *acquis-in* e BE-së të ketë sukses, do të krijohet një mekanizëm i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm. Ky mekanizëm do të mbikëqyrë implementimin e reformave dhe do të sigurojë që masat e ndërmarra për të arritur objektivat e politikës të realizohen siç është planifikuar. Monitorimi do të përfshijë vlerësimin e progresit nga institucionet shtetërore përgjegjëse, që do të sigurojnë që rregulloret dhe praktikatat të zbatohen në përputhje me standardet e BE-së. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi do të jetë përfshirja e aktorëve të ndryshëm, përfshirë bizneset dhe shoqërinë civile, për të siguruar një vlerësim të plotë dhe transparent të ndikimeve dhe progresit të masave të reja. Për më tepër, do të realizohet një monitorim i vazhdueshëm i ndikimit të masave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, për të identifikuar sfida dhe mundësi për përmirësim.

#### Kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre

Për të matur arritjen e objektivave të politikës dhe progresin në implementimin e ligjeve të harmonizuara me *acquis-in* e BE-së, do të përdoren disa kriteret dhe tregues të qartë. Këto përfshijnë:

- **Përputhshmëria:** Një nga kriteret kryesore do të jetë vlerësimi i nivelit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me direktivat dhe rregulloret e BE-së, duke siguruar që të gjitha ligjet e nevojshme janë miratuar dhe implementuar plotësisht.
- **Rritja e FDI:** Një tregues tjetër i rëndësishëm është vlerësimi i rritjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta pas implementimit të ndryshimeve ligjore, si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë. Ky tregues do të matet nëpërmjet raporteve të institucioneve financiare dhe statistikave zyrtare.
- **Përmirësimi i klimës së biznesit:** Ky tregues do të matet nëpërmjet vlerësimeve dhe raportimeve mbi përmirësimin e klimës së biznesit, si dhe nga ecuria e procedurave për regjistrimin e bizneseve dhe lehtësimin e procedurave administrative.
- **Ndikimi tek bizneset në përgjithësi dhe NMV-të në veçanti:** Tregues të tjerë do të përfshijnë vlerësimin e ndikimit në shoqëritë tregtare, duke marrë parasysh se sa mirë këto biznese kanë mundur të përshtaten me ligjet e reja dhe sa lehtë kanë mundur të hyjnë në tregje të reja.
- **Përmirësimi i kapaciteteve institucionale:** Do të maten përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve në institucione si QKB, MEKI, Dhomba Kombëtare e Notarisë, Autoriteti i Konkurrencës etj, përmes trajnimeve dhe përmirësimit të infrastrukturës për zbatimin e rregulloreve të reja. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në mundësinë e mbikëqyrjes efektive të ligjeve të reja.

Këto tregues do të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar progresin dhe për të identifikuar nevojën për përmirësime në masat e ndërmarra, duke siguruar që objektivat e politikës të realizohen në kohë dhe me efektivitet.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

Në analizën e mëposhtme janë marrë në konsideratë vetëm përfitimet për arsye se kostot janë jo vetëm të papërcaktueshme me besueshmëri, por edhe sepse vlera e tyre është jo e rëndësishme krahasimisht me përfitimet.

**Shifrat në tabelë janë të shprehura në milionë (000 000) Lekë.**

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
<b>Kosto në total</b>										
<b>Kosto e zbritur=</b> Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472

Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472
<b>Përfitimet totale</b>	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472
<b>Përfitimi i zbritur</b> = Përfitimi në total x faktori zbritës	472	448.4	429.52	410.64	387.04	372.88	354	335.12	320.96	306.8
<b>Vlera prezente aktuale e përfitimit në total</b>	3,837									
<b>Vlera prezente aktuale e kostos në total</b>										
<b>Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total</b>	3,837									



## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	-	3,837	3,837
Opsioni 2	0	0	0
Opsioni 3			

**MINISTËR**

**BLENDI GONXHJA**